



Institut für vergleichende u. indogermanische
Sprachwissenschaft sowie Albanologie | LMU München

4. Deutsch-Albanische Kultur- Wissenschaftliche Tagung

50 JAHRE ALBANOLOGIE AN DER LMU - MÜNCHEN

23.-25. Juni 2011

Studienhaus Gut Schönwag
Schönwag 4 | 82405 Wessobrunn

KONTAKT:

LUDWIG-MAXIMILIANS-UNIVERSITÄT MÜNCHEN
INSTITUT FÜR VERGLEICHENDE UND INDOGERMANISCHE
SPRACHWISSENSCHAFT SOWIE ALBANOLOGIE

GESCHWISTER-SCHOLL-PLATZ 1
D - 80539 MÜNCHEN
TEL. +49 89 2180 2485 (SEKRÄTARIAT)
TEL. +49 160 91660515 (MOBIL)
FAX +49 89 2180 5345

WWW.ALBANOLOGIE.UNI-MUENCHEN.DE

PROF. DR. BARDHYL DEMIRAJ
DEMIRAJ@LRZ.UNI-MUENCHEN.DE

EMA KRISTO
EMA_KRISTO@YAHOO.CO.UK
TEL. +49 172 1373326 (MOBIL)

50 JAHRE ALBANOLOGIE AN DER LUDWIG-MAXIMILIANS-UNIVERSITÄT MÜNCHEN

(23.-25.06.2011 - Gut Schönwag)

PROGRAMM

1. ARBEITSTAG: FREITAG, 24. JUNI 2011

1. SESSION: 09.00 - 11.10 Uhr

Prof. em. Dr. Wilfried Fiedler (Meißen / Universität Jena)
Zur Geschichte der Morphologie des albanischen Admirativs

Prof. Dr. Kolec Topalli (QSA Tirana)
The topic of terms in Albanian

Dr. Rolf Ködderitzsch (Meckenheim/ Uni Tirana)
Spiranten in der idg. Grundsprache und im Albanischen

Prof. Dr. Walter Breu (Universität Konstanz/ Deutschland)
*Der Präsumptiv im Arbrisht: Formen und Funktionen,
Entwicklung und grammatische Klassifikation*

2. SESSION: 11.30 - 13:00 Uhr

Prof. Dr. Titos Jochalas (Gr. Akad. Wiss. Athen)
La lingua albanese nella Tracia occidentale

Elton Prifti (Uni Potsdam)
Italoalbanisch und italienische Dialekte in Kontakt: Eine migrationslinguistische Analyse

Dr. Aleksander Russakov (Universität St. Petersburg)
Insular and peripheral dialects as a source about the Albanian language history

3. SESSION: 14.30 - 16.30 Uhr

Prof. Dr. Andrej Sobolev (Uni Marburg / Uni St. Petersburg)
Slavische Lehnwörter in albanischen Dialekten

Asz. Prof. Dr. Anila Omari (QSA Tirana)
Die Slawismen in der Altliteratur im nordalbanischen Kulturareal (15.-17. Jh.)

Dr. Larisa Kaminskaja (Universität St. Petersburg)
Gjuha shqipe në leksikografinë ruse në gjysmën e dytë të shekullit XVIII

Dr. Lumnije Jusufi (LMU München)
Historische Migrationen im Spiegel der Dialektlandschaft von Manastir

4. SESSION: 17.00 - 18.30 Uhr

Prof. Dr. Francesco Altimari (Universität Cosenza)
Analisi di alcuni manoscritti con testi e lessemi sull' albanese dell' Istria

Dr. Aleksander Murzaku (Coll. S. Elizabeth/USA)
Finding patterns in texts: a quantitative analysis of qualitative language changes

Besim Kabashi MA (Universität Erlangen)
Ein Valenzlexikon für das Albanische

2. ARBEITSTAG: SAMSTAG, DEN 24. JUNI 2011

5. SESSION: 09.00 - 11.00 Uhr

Prof. Dr. Rexhep Ismajli (ASHAK, Prishtina)
Buzukiana monacensia: Camaj-Fiedler

Dr. Joachim Matzinger (Universität Wien)
Die Heiligenfeste, oder wie sich das Proprium de Sanctis und das Commune Sanctorum im Seelsorgehandbuch des Gjon Buzuku (1555) darstellen

Prof. Dr. Mateo Mandala (Universität Palermo)
Sul dizionario etimologico inedito di Marco La Piana

Dr. Gëzim Gurga (Universität Palermo)
L'opera inedita di Marco La Piana: "Grammatica storica della lingua albanese"

6. SESSION: 11.30 - 13.00 Uhr

Prof. Dr. Tomor Osmani / Dr. Mimoza Prik (Universität Shkodër)
*Njësimi i alfabetit dhe i gjuhës letrare së përbashkët -
dy probleme gjuhësore parësore të viteve të para të shekullit XX*

Dr. Michael Schmidt Neke (Ref. des Arbeitskreises Bildung, Wissenschaft, Forschung und Kultur, Kiel)
Wege zu einem Personenlexikon zur albanischen Geschichte

Dr. PD. Konrad Clewing (Südost-Institut, Uni Regensburg)
Forschung(sdefizite) über Staat und Gesellschaft in Albanien und 'Neualbanien' 1941-1944

7. SESSION: 14:30 - 16.30 Uhr

Prof. em. Dr. Peter Bartl (Pullach / LMU München)
Toleranz und Repression. Die Türkenherrschaft im Spiegel der geistlichen Visitationsberichte aus Nordalbanien

Prof. Dr. Ines Angjeli Murzaku (Seton Hall Univ. / USA)
Catholic Missionaries' Bitter and Meager Victories in Albania

Prof. Dr. Shaban Sinani (QSA Tirana)
Ndikimi i ligjërit ungjillor në kodet tradicionale etno-juridike të shqiptarëve

Ass. Prof. Dr. Persida Asllani (Universität Tirana)
Miti i gjakut në prozën shqipe: Mit identitar dhe letrar

8. SESSION: 17.00 - 18.00 Uhr

Prof. Dr. Ardian Ndreca (Uni Pont. Urbaniana)
Law Isonomie in the Albanian customary right

Dr. Nicola Scaldaferrri (Università di Milano)
Audiovisual Media and Albanian Diaspora. New Research of the Ethnomusicology and Visual Anthropology Laboratory (LEAV - University of Milan)

Dr. Robert Elsie (Den Haag)
Some Observations on Albanian and Bosnian Epic Traditions

ABSTRACTS

1. ARBEITSTAG: FREITAG, 24. JUNI 2011

1. SESSION: 09.00 - 11.10 Uhr

Prof. em. Dr. Wilfried Fiedler
(Meißen / Universität Jena)

ZUR GESCHICHTE DER MORPHOLOGIE DES ALBANISCHEN ADMIRATIVS

Der Beitrag beschäftigt sich vorrangig mit der Morphologie und Morphosyntax und berührt die Semantik nur, soweit es die Einordnung des alb. Admirativs in die Typologie von Verbsystemen erfordert. Wenn man die von Jokl und Riza vertretene Herkunft des Admirativs aus einem präsumtivisch gebrauchten Futur ablehnt, ist so zu Beginn eine Abgrenzung der funktional-semantic Kategorien Admirativität (Ausdruck der Verwunderung) und Kommentativität =(Re)narrativität=Referativität (Wiedererzählung) von der Präsumtivität (Vermutung) erforderlich - diese drei werden z.B. von V. Friedman als "non-confirmative" zusammengefasst. Es folgt eine Zusammenstellung und strukturelle Charakterisierung aller in grammatischen Beschreibungen des Alb. (K. Kristoforidhi, S. Frashëri; E. Lafe, S. Riza) angeführten Admirativformen. Als adäquateste Beschreibung ergibt sich die Herausnahme des Admirativs aus den Modi und der Ansatz eines besonderen admirativischen neben dem nichtadmirativischen System. Die vier bzw. sechs Tempora des einfachen Admirativs werden so innerhalb des admirativischen Systems (nach E. Lafe) als "Indikativ-Admirativ" bezeichnet, und die Kombinationen mit formbildenden Partikeln (wie *do*, *të*, *në*, *po*, *dot...*) werden als besondere Formen, meist als "nichtindikativische" Modi innerhalb dieses Systems definiert. Sie werden zum großen Teil durch Beispiele aus der moderneren Sprache (vor allem aus "Lumi i vdekur" von Xoxa) nachgewiesen.

Die Darstellung der Entwicklung des Admirativs in "literarischer Zeit" beginnt mit der Analyse der "indikativischen" und "nichtindikativischen" Admirativ-Belege bei Buzuku. Es ergibt sich, dass die Stämme der Admirativformen bei Buzuku durchweg vom Partizipialstamm abgeleitet sind, aber doch schon Ansätze zu einem besonderen Admirativstamm zeigen. Die Endungen - mindestens die des Imperfekts des Aktivs - stimmen nur zum Teil mit denen des Hilfsverbs "habere" überein; sie entsprechen zunächst vielmehr den Endungen der nichtadmirativischen Nichtaktivformen. Im Laufe der Entwicklung nach Buzuku zeigen sich stärkere Ansätze zu einem besonderen Admirativstamm, der neben Merkmalen des Partizipialstamms auch solche des Präsens- und gelegentlich des Aoriststamms enthalten kann. Diese Tendenz, die aus typologischer Sicht eine starke synthetische Komponente innerhalb des alb. Verbalsystems erweist, wurde durch die Orthographiereform von 1972 gestoppt.

Zum Schluss ergibt ein vor allem auf der Basis von Strukturformeln durchgeführter Vergleich des albanischen Admirativ-Systems mit dem (Re)narrativ-System des Balkanslavischen (Bulgarisch-Makedonischen) sehr große Unterschiede. Dennoch lässt sich als eine Gemeinsamkeit, als ein "Balkanismus distanced forms (DF)" ein Bündel übereinstimmender Merkmale definieren:

1. Die DF stellen nicht einen "Modus" dar, sondern ein besonderes, teils paralleles System zum sonstigen Verbalsystem, den "non distanced forms (NDF)";
2. Die "Komponenten" des Präsens der DF (z.B. 2.Person Sg. *pas(ur)+ke/[ti] si+imal*) entsprechen bis zu einem gewissen Grad den "Komponenten" des Perfekts der NDF (z.B. *ke+pasur/[ti] si+imal*);
3. Die DF dient sowohl zum Ausdruck von Admirativität, als auch von Kommentativität=(Re)narrativität, jedoch in den beiden Sprachgebieten mit unterschiedlicher semantischer Markiertheit;
4. Es gibt eine Tendenz zur Bildung eines weiteren, eines emphatischen Präsens der DF aus dem Perfekt der DF;
5. Die DF können wie die NDF mit formbildenden Partikeln versehen sein, doch sind sie es seltener.

RRETH HISTORISË SË MORFOLOGJISË SË ADMIRATIVIT NË GJUHËN SHQIPE

Kumtesa merret në radhë të parë me morfologji dhe morfosintaksë dhe prek semantikën vetëm aq sa kërkohet për të vendosur admirativin e shqipes në tipologjinë e sistemeve foljore. Kështu nevojitet që në fillim të bëhet një ndarje e kategorive funksionale-semantike të admirativitetit (shprehja e habisë), komentativitetit = (re)narrativitetit = referativitetit (ritregimi), dhe presumptivitetit (hamendja), nëse mohohet prejardhja e admirativit nga një futur presumtiv, ashtu siç mendonin albanologët Jokl dhe Riza. Këto tri tipare V. Friedman i përmbledh si "non confirmative".

Më tej vazhdon një përmbledhje dhe karakterizim strukturor i të gjitha trajtave të habitores në përshkrimet gramatikore të shqipes (K. Kristoforidhi, S. Frashëri; E. Lafe, S. Riza). Si përshkrim adekuat del përjashtimi i admirativit nga mënyrat dhe postulimi i një sistemi të veçantë të admirativit krahas sistemit joadmirativ. Kështu brenda sistemit admirativ të katra resp. të gjashtë kohët e admirativit të thjeshtë emërtohen (sipas Lafes) si "indikativ-admirativ", kurse kombinimet me pjesëza trajtëformuese (si do, të, në, po, dot...) definojnë si trajta të veçanta, në të shumtën e rasave si mënyra jodëftore brenda këtij sistemi. Këto trajta demonstron me shembuj nga gjuha moderne (si p.sh. nga "Lumi i vdekur" i J. Xoxës).

Paraqitja e zhvillimit të admirativit në dokumentet e shtypura fillon me përshkrimin e trajtave indikative dhe joindikative të admirativit të Buzuku. Aty del qartë se të gjitha temat e trajtave të admirativit rrjedhin nga tema e participit. Megjithatë ka shenja fillestare të një teme të veçantë admirative. Mbaresat - të paktën ato të imperfektit aktiv - u përgjigjen vetëm pjesërisht atyre të foljes ndihmëse "habere"; fillimisht ato përkonin me mbaresat e trajtave përkatëse joaktive të joadmirativit. Përgjatë zhvillimit të tyre, pas Buzukut, dalin gjithnjë e më shumë e gjithnjë më të forta shenjat e një teme të veçantë admirative, e cila mund të përmbajë në vend të tipareve të temës së participit edhe aso të prezentit dhe, herë pas here, të aoristit. Kjo tendencë, e cila nga pikëpamja tipologjike tregon një komponente të fortë sintetike brenda sistemit foljor të shqipes, u ndërpre nga reforma drejtshkrimore e vitit 1972.

Në fund, nga një krahasim bërë në bazë të formulave strukturore të habitores së shqipes me sistemin (re)narrativ të sllavishtes ballkanike (bullgaro-maqedone) rezultojnë dallime të mëdha. Megjithatë, si një ballkanizëm "distanced formes (DF)", mund të kufizohet një tufë (përmbledhje) tiparesh të përbashkëta:

1. DF nuk janë një "mënyrë", por një sistem i veçantë, paralel me sistemin tradicional foljor të "non distanced forms (NDF)";
2. Komponentet e sistemit të DF (p.sh. v. e dytë nj. prezenti: pas(ur)+ke/ [ti] si+imal) u përgjigjen deri në një masë të caktuar komponenteve të perfektit të NDF (p.sh. ke+pasur/ [ti] si imal).
3. DF shërben edhe si shenjë e admirativitetit, edhe si shenjë e komentativitetit = (re)narrativitetit, por në të dyja familjet gjuhësore me markim semantik të ndryshëm.
4. Çfaqet një tendencë për krijimin e një prezenti të mëtejshëm, emfatik, nga perfekt i DF.
5. DF mund të kombinohen, si edhe NDF, me pjesëza trajtëformuese, por këto kombinime janë më të rralla se ato të NDF.

* * *

Prof. Dr. Kolec Topalli
(QSA Tirana)

THE TOPIC OF TERMS IN ALBANIAN

The rules for the placement of words in the sentence change from one language to the other. This situation is especially connected to the level of development of the inflectional system. In general the richer the inflectional system of a language, the more independent the constituents in the sentence are from each other. Conversely, the more impoverished the inflectional system, the more dependent the sentence-level connectors are on each other. According to this principle, the older, attested IE languages had a developed inflectional system and, thus, also had a relatively free word order in terms of the connectors in the sentence, whereas the newer languages, in which the inflectional system has partially or completely disappeared, have developed a tendency of fixed word order. This phenomenon is especially characteristic for the Romance and Germanic languages, where the word order takes on a grammatical value, while the Balto-Slavic languages, which have preserved better the inflectional system, have a relatively free word order for the connectors in the sentence. However, with all of the

differences that languages may have amongst themselves in regards to the placement of the constituents in the sentence, the languages within a family have some shared rules that were inherited a long time ago and have been preserved, including today's modern languages.

In Albanian the inflectional system has not disappeared, even given all the reductions and simplifications. It has a relatively free word order in regard to the major constituents in the sentence. The scale of the fixedness of the sentence-level elements depends on their role in the sentence. Some of them are more autonomous and may move more freely in the sentence, such as: the nouns that serve as the subject or object, verb predicates, pronouns and cardinal numerals when not accompanied by nouns, and adverbs that serve as complements of circumstance. Other constituents, however, are less autonomous and, thus, their ordering is more rigid and fixed in the sentence, as they are dependant upon one another, such as: adjectives, nouns in the genitive case, pronouns and cardinal numerals when accompanied by a noun, ordinal numerals, pronominal short forms, verbs in the subjunctive mood when connected with another verb, prepositions, particles of negation, and so on.

The autonomous terms have a sort of independence in terms of their placement in the sentence. Despite this, they are also subjected to the rules that especially depend on the aim of the sentence. In affirmative sentences, as a rule, the subject is in the sentence-initial position, then the predicate, and next come the other constituents (e.g. the direct and indirect objects and the complement of circumstance). The placement of the subject in the first position is a rule that is especially applied in languages that have lost their inflectional system of endings, thereby marking them with analytic linguistic tools, with personal pronouns that have become obligatory. Such languages include the Romance languages, German, and especially English. However, the Albanian language has a relatively well-developed system of verbal inflections, and many times the sentence begins with a verb, without a subject, e.g. *kam ardhur për punë* '(I) have come for work'; *u ngrita herët në mëngjes* '(I) got myself up early in the morning'. The normal, basic word order *subject-predicate* is inverted in some types of dependent clauses and sentences, where the verb surfaces immediately after the conjunction, placing the subject after the predicate, e.g. *do të nisemi kur të dalë dielli* '(We) will leave when the sun rises'. Also, in interrogative sentences that do not begin with a pronoun or interrogative adverb, but with or without the interrogative particle *a* (i.e. the question marker), the predicate precedes the subject, e.g. *A ka ardhë ndokush?* 'Has anyone come?' *Erdhi njeri?* 'Did anyone come?'

The non-autonomous terms are placed either *before* or *after* the terms on which they are dependent. The majority of them are positioned before a given word, such as: demonstrative pronouns (with the exception of *i tillë, e tillë* 'such'), interrogative pronouns, the majority of indefinite pronouns, and indefinite nouns that serve as clarifying appositions, whereas the following appear after a given word: adjectives, the demonstrative pronouns *i tillë ~ e tillë*, ordinal numerals, and nouns in the genitive case. The specified position before the given word is an inherited phenomenon from PIE, since both the old and new IE languages have it. The position after a given word, however, is a phenomenon that is a result of language internal developments in Albanian that are connected with the appearance of articles and, thus, it is relatively new.

TOPIKA E GJYMTYRËVE TË FJALISË NË GJUHËN SHQIPE

Rregullat e vendosjes së fjalëve në fjali ndryshojnë nga njëra gjuhë në tjetrën. Kjo lidhet sidomos me shkallën e zhvillimit të sistemit të eptimit. Përgjithësisht, sa më të pasur ta ketë sistemin e eptimit një gjuhë, aq më të pavarura janë gjymtyrët e fjalisë nga njëra-tjetra, si rrjedhim, aq më e lirë është topika e tyre; përkundrazi, sa më të varfër ta ketë sistemin e eptimit, aq më të varura bëhen gjymtyrët e fjalisë nga njëra-tjetra, si rrjedhim, aq më e shtrënguar është topika e tyre. Sipas këtij parimi, gjuhët e vjetra, që kanë pasur një sistem eptimi të zhvilluar, kanë pasur një rend relativisht të lirë të gjymtyrëve të fjalisë. Kurse gjuhët e reja, që e kanë zhdukur tërësisht ose pjesërisht sistemin e eptimit me mbaresa, kanë zhvilluar prirjen për rend të ngulitur. Kjo dukuri është karakteristike sidomos për gjuhët romane e gjermanike, ku rendi i fjalëve merr vlera gramatikore; kurse gjuhët balto-sllave, që e kanë ruajtur më mirë sistemin e eptimit, kanë një rend relativisht më të lirë të gjymtyrëve të fjalisë. Por me gjithë ndryshimet që mund të kenë gjuhët nga njëra-tjetra në vendosjen e gjymtyrëve të fjalisë, gjuhët e një familjeje kanë disa rregulla të përbashkëta, që i kanë trashëguar qëmoti dhe i ruajnë edhe në ditët e sotme.

Gjuha shqipe, që nuk e ka zhdukur sistemin e eptimit me mbaresa, me gjithë reduktimin e tij të fortë, ka një rend relativisht të lirë të gjymtyrëve të fjalisë. Megjithëkëtë, shkalla e ngulitjes së gjymtyrëve varet nga roli i tyre në fjali. Disa prej tyre, siç janë: emrat që shërbejnë si kryefjalë a kundrinë, foljet-kallëzues, përemrat e numërorët themelorë kur nuk shoqërohen nga emra, ndajfoljet që shërbejnë si rrethanorë, janë më të mëvetësishme dhe mund të lëvizin më lirisht në fjali. Kurse disa të tjera, si: mbiemrat, emrat e rasës gjinore, emrat e pashquar që shërbejnë si ndajshtime caktuese; përemrat dhe numërorët themelorë kur shoqërohen nga një emër; numërorët rreshtorë, format e patheksuara përemërore, foljet e mënyrës lidhore kur lidhen me një folje tjetër; parafjalët, pjesëzat e mohimit etj., janë të pamvetësishme, pasi kanë rend të ngulitur në fjali, gjë që lidhet me varësinë e tyre nga një fjalë tjetër.

Gjymtyrët e mëvetësishme kanë njëfarë pavarësie në vendosjen e tyre në fjali, megjithëkëtë, edhe ata u nënshtrohen rregullave, që varen sidomos nga qëllimi i kumtimit e lloji i fjalisë. Në fjalinë dëftore, si rregull, në fillim vendoset kryefjala, pastaj kallëzuesi dhe pas tij vijne gjymtyrët e tjera (kundrinat, rrethanorët). Vendosja e kryefjalës në vend të parë është një rregull që zbatohet sidomos në ato gjuhë që e kanë humbur sistemin e eptimit me anë të mbaresave duke i shënuar ato me mjete analitike, me përemrat vetorë që janë bërë të detyrueshëm. Gjuhë të tilla janë gjuhët romane e gjermanike, sidomos anglishtja. Por gjuha shqipe, që e ka të zhvilluar relativisht mirë sistemin e mbaresave foljore, shpeshherë e fillon fjalinë me folje, pa shënuar kryefjalën; p.sh.: kam ardhur për punë; u ngrita herët në mëngjes. Por rendi normal kryefjalë-kallëzues përmbysset në disa tipa fjalish të varura, ku folja del menjëherë pas lidhëzës duke zhvendosur kryefjalën pas kallëzuesit; p.sh.: do të nisemi kur të dalë dielli. Edhe në fjalitë pyetëse që nuk fillojnë me përemra a ndajfolje pyetëse por me pjesëzën a ose pa të, kallëzuesi vihet para kryefjalës; p.sh.: A ka ardhë ndokush? Erdhi njeri?

Gjymtyrët e pamvetësishme vendosen para ose prapa gjymtyrës nga e cila varen. Para fjalës së përcaktuar qëndron shumica e tyre, si përemrat dëftorë (me përjashtim të i tillë, e tillë), përemrat pyetës, shumica e përemrave të pacaktuar dhe emrat e pashquar që shërbejnë si ndajshtim caktues. Kurse pas fjalës së përcaktuar qëndrojnë mbiemrat, përemrat dëftorë i tillë ~ e tillë, numërorët rreshtorë dhe emrat e rasës gjinore. Pozicioni i përcaktorëve para fjalës së përcaktuar është dukuri e trashëguar, mbasi atë e kanë gjuhët e vjetra e të reja; kurse pozicioni pas fjalës së përcaktuar është dukuri e zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe, që është e lidhur me shfaqjen e nyjave, prandaj ajo është relativisht më e re.

* * *

Dr. Rolf Ködderitzsch
(Meckenheim/ Uni Tirana)

SPIRANTEN IN DER IDG. GRUNDSPRACHE UND IM ALBANISCHEN

Mehr als 93 % der natürlichen Sprachen haben Phonemsysteme mit mindestens einem Spiranten bzw. Frikativ. Die Mehrzahl der Sprachen ohne Frikative werden von australischen Aborigines gesprochen. Bei den einzelnen Indogermanisten differiert das von ihnen für die Grundsprache angenommene Phonemsystem erheblich. So nahm beispielsweise der Italiener Vittore Pisani, was die idg. Spiranten betrifft, einen Sibilanten [s] mit den allophonischen Varianten [z] und [z^h] und einen dentalen Frikativ [θ]/[an, wobei letzterer in den idg. Tochttersprachen Metathese verursachen oder einfach fehlen könne, so dass man in manchen Fällen auch an die Adaption von aus nicht-idg. Sprachen entlehnten Konsonantengruppen denken müsse. Moderne Gelehrte nehmen für die idg. Grundsprache nur einen Spiranten, nämlich [s] an, und keinen dentalen Frikativ mehr, vor allem weil er ausschließlich hinter tektalen Plosiven anzusetzen war. Stattdessen werden neben den Verschlusslautreihen auch Laryngale angenommen, wobei die Anzahl der Laryngale (eins, zwei, drei, vier, sechs oder gar noch mehr) und ihr phonetischer Wert umstritten sind. Es spricht vieles dafür, dass die Laryngale der Grundsprache tektale Spiranten waren. Reflexe im Albanischen zeigen, dass von vier „Laryngalen“ in der idg. Grundsprache auszugehen ist. Keiner der idg. Spiranten ist unverändert in der alb. Sprache erhalten. Die moderne alb. Sprache verfügt über mehr Spirantenphoneme als die idg. Grundsprache: labiodentales [f] und [v], apikodentales [θ] und [θ̥][alveolares [s] und [z], palato-alveolares [ʃ] und [ʒ], glottales [h]. Die Phoneme [j] und das unlängst Phonemstatus erlangt habende [w] sind wohl eher als Approximanten denn als Spiranten zu betrachten.

Die apikalen, alveolaren Vibranten /r/ und /r:/ werden heutzutage vor allem in Mittelalbanien immer öfter uvular artikuliert, zumeist als Frikativ [ʀ], so dass der Unterschied zwischen /r/

und /r:/ neutralisiert wird. Diese und ähnliche Zusammenhänge, vor allem solche, die den Zusammenhang zwischen dem Protoidg. und dem Alb. betreffen, sollen analysiert werden.

BASHKËTINGËLLORET SPIRANTE NË GJUHËN BAZË IE. DHE NË SHOIQE

Më shumë se 93% e gjuhëve natyrore kanë në përbërje të sistemeve të veta fonetike të paktën një bashkëtingëllore spirante apo frikative. Shumica e gjuhëve pa këto bashkëtingëllore fliten nga popullsia aborigjene në Australi. Tek secili indoeuropianist vërejmë dallime rrënjësore, sa i përket njohjes së inventarit të sistemit fonetik të gjuhës bazë. Kështu për shembull, lidhur me spirantet indoevropiane, gjuhëtari italian i Vittore Pisani vjen në përfundimin se ekziston një sibilant [s] me variantet alofonike [z] dhe [zʰ] si edhe dhe një frikative dentale [θ]/[ð]; kjo e fundit në gjuhët simotra indoevropiane mund të shkaktojë, por edhe mund të mungojë fare, e në këtë mënyrë në disa raste mund të përsiatet mundësia e një përshtatjeje të grupeve të bashkëtingëlloreve të huazuara nga gjuhët e tjera jo-indoevropiane. Gjuhëtarë bashkëkohorë i njohin gjuhës bazë indoevropiane vetëm një spirante, pikërisht [s]-në dhe nuk pranojnë në asnjë rast të ketë pasur një frikative dentale, meqë ajo mund të rindërtohet me fort vetëm në pozicion pas bashkëtingëlloreve mbylltore tektale. Në vend të saj pranohen krahas radhëve të bashkëtingëlloreve mbylltore edhe laringalet (një, dy, tri, katër, gjashtë madje edhe më shumë në numër), edhe pse vlera e tyre fonetike është më se e diskutueshme. Shumë rrethana tumirin mendimin që laringalet e gjuhës bazë të kenë qenë spirante tektale. Reflektet fonetike në gjuhën shqipe lejojnë të përsiatet, që në gjuhën bazë indoevropiane të gjëllinin katër fonema "laringale". Asnjë prej spiranteve indoevropiane nuk rezulton të jetë e pandryshuar në gjuhën shqipe. Gjuha e sotme shqipe zotëron më shumë fonema spirante sa syresh në gjuhën bazë indoevropiane: labiodentalet [f] dhe [v], apikodentalet [θ] dhe [ð], alveolaret [s] dhe [z], palato-alveolaret [ʃ] dhe [ʒ], glotalja [h]. Fonema [j] dhe fonema [w], e cila ka fituar para do kohësh statusin e një foneme më vete, duhet të konsiderohen më fort si aproksimante, sesa si spirante.

Bashkëtingëlloret vibrante apikale alveolare /r/ und /r:/, sidomos zonën e Shqipërisë së Mesme, nyjëtohen sot gjithnjë e më shumë si uvulare, pak a shumë si frikativja [ʁ], e në këtë mënyrë neutralizohet edhe dallimi midis /r/ dhe /r:/. Në këtë kumtesë do të merren në analizë pikërisht rrethana të tilla apo të ngjashme, sidomos sosh që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet protoindoevropianishtes dhe gjuhës shqipe.

* * *

Prof. Dr. Walter Breu

(Universität Konstanz/ Deutschland)

DER PRÄSUMPTIV IM ARBRISHT: FORMEN UND FUNKTIONEN, ENTWICKLUNG UND GRAMMATISCHE KLASSIFIKATION

Das Arb(ë)risht (Italoalbanisch) ist hinsichtlich der Funktion von Perfektformen relativ stark gegliedert. Neben einem rein temporalen Perfekt, das zudem den Aorist fast vollständig ersetzt hat (z.B. San Nicola), finden wir ein aspektuell beschränktes Perfekt (z.B. Piana), das in der Hauptsache nur experientielle und allenfalls resultative Funktion aufweist. Die Mehrzahl der italoalbanischen Dialekte verfügt überhaupt nur über ein modales Perfekt, während die indikativischen temporalen und aspektuellen Funktionen vom Aorist übernommen werden. Es handelt sich hierbei um ein konsistentes Areal, das das Arbrisht von der Provinz Cosenza über die Basilikata und Kampanien bis in den Molise erfaßt. Eine Konstruktion wie etwa *ka u zgjuar e jëma* (San Martino) bedeutet hier niemals einfach 'die Mutter ist aufgewacht', sondern sie hat stets präsumptiven Charakter: 'ich nehme an, daß die Mutter aufgewacht ist', ähnlich *ka rat shi* (Frascineto) 'es scheint, als habe es geregnet'. Eine genauere Untersuchung zeigt, daß dieses präsumptive „Perfekt“ Teil eines umfassenderen Modalparadigmas für alle Tempora ist, in dem auch das sonst im Arbrisht geschwundene Futurauxiliar *do* eine Rolle spielt. Mein Vortrag wird sich mit der Verankerung des Präsumptivs im Verbsystem befassen, mit Fragen der historischen Entwicklung, insbesondere mit dem Problem einer möglichen Induktion durch Sprachkontakt, sowie auch mit der Position des Präsumptivs in einem semantischen Feld der Modalität. Der Vergleich mit anderen Sprachkontaktsituationen in Italien sowie die Rolle des Auxiliars *kam* im Vergleich diverser Varietäten des Albanischen gehört ebenfalls zum Themenbereich des Vortrags.

PRESUMPTIVI NË ARBRISHT:

FORMAT DHE FUNKSIONET, ZHVILLIMI DHE KLASIFIKIMI GRAMATIKOR

Përsa i përket funksionit të formave të së kryerës arbrishtja karakterizohet nga një larmishmëri e theksuar. Krahas së kryerës temporale të mirëfilltë, e cila zëvendëson pothuajse tërësisht të kryerën e thjeshtë (p.sh. në të folmen e Shënkollit), hasim dhe një të kryer të kufizuar aspektualisht (p.sh. në të folmen e Horës), e cila në thelb ka vetëm një funksion eksperiencial dhe pjesërisht edhe një funksion rezultativ. Por në pjesën më të madhe të dialekteve italoarbreshe haset vetëm një formë e kryer modale, ndërsa funksionet dëftore kohore dhe aspektuale mbulohen prej së kryerës së thjeshtë. Bëhet fjalë për të folme që shtrihen në një zonë të gjerë, që zë fill me arbërishten e provincës së Kozencës dhe vazhdon më tej me arbërishten e Bazilikatës, të Kampanjës deri tek ajo e Molizit. Një konstrukt i tillë, si fjala vjen ka u zgjuar e jëma (Shën Martin) nuk do të thotë aspak thjesht 'nëna u zgjuar'; konstrukt i tillë ka gjithmonë karakter presumtiv: 'ka të ngjarë, që nëna të jetë zgjuar', e ngjashme me ka rat shi (Frazniti) 'duket sikur të ketë rënë shi'. Nga një analizë më e detajuar del në pah se kjo formë „e kryer“ është pjesë e një paradigme modale më gjithëpërfshirëse për të gjitha kohët. Në to luan rol ende pjesëza ndihmëse e së ardhmes do, e cila përndryshe është zhdukur në të folmet arbërisht. Në kumtesën time përshkruhet inkuadrimi i presumtivit në sistemin foljor, trajtohen çështje të zhvillimit historik të tij, në veçanti gjatat e kristalizimit të këtij fenomeni si rrjedhojë e kontaktit gjuhësor, si dhe vendi që zë në sferën semantike të modalitetit. Në kuadrin e kumtesës bëhet dhe krahasimi me situata të tjera kontakti gjuhësor në Itali, si dhe përshkruhet roli që luan folja ndihmëse kam në përfaqje me varietete të tjera të shqipes.

2. SESSION: 11.30 - 13:00 Uhr

Prof. Dr. Titos Jochalas

(Gr. Akad. Wiss. Athen)

LA LINGUA ALBANESE NELLA TRACIA OCCIDENTALE

La storia della diaspora albanese, svoltasi soprattutto in due Paesi, in Grecia e in Italia, copre una gran parte della storia medievale e moderna dell'Albania.

Di queste colonie albanesi, formatesi fuori dell'Albania, si sono occupati fino ad oggi non soltanto la ricerca storica, ma anche la linguistica albanese, la dialettologia, la letteratura albanese e la sua storia, il folklore, la musicologia, diventando così la storia della diaspora albanese: una specie di "Kulturgeschichte" dell'Albania stessa.

La mia ricerca si è concentrata nella storia, poco nota, dei paesi albanofoni della Tracia orientale: Qyteze, Sulltanqoj, Alltentash, Pazardere nel territorio di Kessani, come anche dei paesi albanofoni Zallef, Picolo Zallef e Abalar nel territorio di Uzunkopru.

Nel 1922 questi paesi furono evacuati e i loro abitanti si stabilirono nel territorio greco della Tracia occidentale, formando nuovi paesi, che ho potuto visitare brevemente nel 1992. Mi soffermerò facendo alcune osservazioni riguardanti la loro lingua e i loro canti tradizionali.

GJUHA SHQIPE NË TRAKINË PERËNDIMORE

Historia e diasporës shqiptare, e cila lidhet kryesisht me dy vende, Greqinë dhe Italinë, përfshin periudha të gjata kohore të historisë mesjetare dhe moderne të Shqipërisë.

Këto koloni shqiptare, të krijuara jashtë Shqipërisë, janë bërë objekt hulumtimi deri në ditët tona jo vetëm në studimet historike, por edhe në disiplinat e gjuhësisë, të dialektologjisë, të letërsisë shqiptare dhe historisë së saj, të folklorit, muzikologjisë, e në këtë mënyrë vetë historia e diasporës shqiptare është bërë një lloj 'historie e kulturës' së Shqipërisë.

Studimet e mia lidhen me historinë pak të njohur të rajoneve albanofone të Trakisë Perëndimore: Qyteze, Sulltanqoj, Alltentash, Pazardere në territorin e Kessan-it, si edhe në fshatrat albanofone Zallef, Zallef i Vogël dhe Abalar në zonën e Uzunkopru-t.

Në vitin 1922 këto fshatra ishin evakuuar dhe banorët e tyre u vendosën në territorin grek të Trakisë Perëndimore, duke themeluar aty fshatra të reja të reja, të cilat kam mundur t'i vizitoj kalimthi në vitin 1992. Në ligjëratën time lejohem të kumtoj disa vëzhgime që kanë të bëjnë me gjuhën si edhe këngët e tyre popullore tradicionale.

* * *

Elton Prifti

(Uni Potsdam)

ITALOALBANISCH UND ITALIENISCHE DIALEKTE IN KONTAKT: EINE MIGRATIONSLINGUISTISCHE ANALYSE

Keywords: *Migrationslinguistik, funktionale Variationslinguistik, Albanologie, Romanistik, Dynamiken von Sprachkontakt und Sprachwandel, Arbërisht, Italoromanisch*

Albanische Varietäten befinden sich vielerorts in sehr dynamischen migrationsbedingten Sprachkontakten, woraus sich nicht selten stabile Hybridvarietäten entwickeln. Zu den bekanntesten und wichtigsten zählt das *Arbërisht*. Im Rahmen des Vortrages stehen die relevantesten Dynamiken des vertikalen und konvergenten Sprachkontaktes zwischen *Arbërisht* und italoromanischen Primärdialekten, die aus einer funktionalen migrationslinguistischen Perspektive betrachtet werden.

Diese empirisch fundierte und diachron orientierte Analyse beruht systematisch auf die dreifache Wahrnehmung der Sprache als Wissen, Tätigkeit und Produkt und bezieht sich auf drei unterschiedliche Stufen des kontaktbedingten Konvergenzprozesses.

Abschließend wird das hohe Potential der albanologischen Forschungen im Bereich der zeitgenössischen Migrationslinguistik und -kulturwissenschaft erörtert und einige wichtige perspektivische Desiderata vorgestellt.

ARBËRISHTJA NË KONTAKT ME DIALEKTE ITALIANE. NJË ANALIZË NGA KËNDVËSHTRIMI I GJUHËSISË MIGRACIONALE

Fjalë çelësa: *Gjuhësi migracionale, gjuhësi funksionale variazionale, albanologji, romanistikë, dinamika të kontaktit gjuhësor dhe ndryshimi gjuhësor, arbërisht, varietete italoromanike*

Si pasojë e emigrimit të shqipfolësve, varietetet shqipe gjenden në një mori vendesh në procese të larmishme e tejet dinamike kontakti gjuhësor. Jo rrallë, në këto kushte, kristalizohen varietete hibride gjuhësore të qëndrueshme. Ndër varietetet më të rëndësishme e me të njohura të kësillojshme bën pjesë edhe arbërishtja. Thelbin e kumtesës e përbën përshkrimi i dinamikave të kontaktit gjuhësor konvergjent dhe vertikal midis arbërishtes dhe dialekteve italoromanike nga këndvështrimi i gjuhësisë funksionale migracionale.

Kjo analizë empirike bazohet në mënyrë sistematike mbi perceptimin treplanësh të gjuhës si njohuri, veprimtari dhe produkt. Në këtë kuadër hulumtimi përqendrohet mbi tri nivele të procesit të konvergjencës që rrjedhon prej kontaktit gjuhësor në fjalë.

Në mbyllje të kumtesës përshkruhet përmbledhtazi potenciali i veçantë i gjurmimeve albanologjike në lëmin e disiplinave bashkëkohore të gjuhësisë dhe studimeve kulturore migracionale si dhe ravijëzohen shkurtimisht disa objekte konkrete premtuese hulumtimi.

* * *

Dr. Aleksander Russakov

(Universität St. Petersburg)

INSULAR AND PERIPHERAL DIALECTS AS A SOURCE ABOUT THE ALBANIAN LANGUAGE HISTORY

The research work on the insular and peripheral Balkan dialects may be rather insightful for the clarification of some complicated moments of the Albanian language history. So, f.ex. the Albanian dialects of the Azov area show a number of archaic traits, which allow us to make some important generalizations concerning the history of Albanian. In particular, "genetically belonging" to the Northern Tosk dialect, this idiom shows some traits that are characteristic of the Gheg and Southern Tosk dialects. These facts seem to support the idea of A.V.Desnitskaya that the linguistic traits of the

Northern Tosk dialects indicate the conservation of some trends of development characteristic of Albanian dialects in general; this conservation is probably due to the language shift of non-Albanian speakers to Albanian. On the other hand, the idiom also demonstrates some innovative features. Another example which will be examined in the paper is the peripheral Dibra dialects which are characterized by the absence of some common-Gheg innovations, by the preservation of the Central Gheg phonetic developments, by the specific innovations, some of which demonstrate contact character. This unique combination of features let us make some conclusions concerning the chronology of the processes of the Albanian language changes.

DIALEKTET E DIASPORËS SI MATERIAL BURIMOR PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE

Puna kërkimore mbi dialektet e diasporës mund të jetë më se domethënëse, sa i përket shtjellimit të disa çështjeve të komplikuara në historinë e gjuhës shqipe. Kështu p. sh. të folmet shqiptare në zonën e Detit Azov shfaqin një numër tiparësh arkaikë, të cilat na lejojnë të bëjmë përgjithësime të rëndësishme lidhur me historinë e vetë gjuhës shqipe. "Duke i përkitur gjenetiksht" sidomos dialektit të toskërishtes veriore, këto të folme shfaqin edhe disa tipare, të cilat janë karakteristike për dialektin tosk të jugut si edhe atë të gegnishtes. Këto fakte gjuhësore duket se mbështesin mendimin e dikurshëm të A. V. Desnickajas, për të cilën tiparet gjuhësore të të folmeve të toskërishtes veriore dëshmojnë konservimin e disa prirjeve zhvillimi që janë karakteristike për dialektet e shqipes në përgjithësi. Ky konservim është pas gjase rrjedhojë e mutacioneve gjuhësore të jo-shqipfolësve në shqipe. Nga ana tjetër, këto të folme shfaqin edhe disa tipare risimi. Një tjetër shembull, i cili do të merret në shqyrtim në kumtesë është ai i dialekteve periferike të Dibrës, të cilat i karakterizon mungesa e disa risive tipike të gegnishtes së përbashkët, konservimi i dukurive fonetike në gegnishten qëndrore, si edhe risitë specifike, disa prej të cilave janë rezultat i kontaktit gjuhësor. Ky kombinim i veçantë i tipareve na lejon të nxjerrim disa përfundime që kanë të bëjnë me kronologjinë e proceseve të ndryshimit gjuhësor në historinë e gjuhës shqipe.

3. SESSION: 14.30 - 16.30 Uhr

Prof. Dr. Andrej Sobolev
(Uni Marburg / Uni St. Petersburg)

SLAVISCHE LEHNWÖRTER IN ALBANISCHEN DIALEKTEN

Nachdem das fast vollständige Inventar der slavischen Lehnwörter im Albanischen nun in zahlreichen Publikationen (von Miklosich, Jokl, Seliščev, Desnickaja, Çabej, Svane, Pešikan, Ylli, Orel u.a.) ziemlich gut bekannt geworden ist, gewinnt das alte Problem ihrer chronologischen, semantischen und sprachgeographischen Schichtung wieder an Gewicht, wenn man die Fragen zu beantworten vermag, wo und wann genau, von wem und unter welchen Umständen welche Slavismen in welche albanische Dialekte eingedrungen sind. Unter anderem, um die älteste Entlehnungsschicht von allen neueren abzusondern, muß man neben phonetischen Kriterien auch areale berücksichtigen und die lokalen Slavismen von allgemein-albanischen abtrennen. Hier kann sowohl die Balkanlinguistik, als auch die moderne albanische Sprachgeographie (Gjinari J., Beci B., Shkurtaç Gj., Gosturani Xh., Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. Vëllimi I, II. Napoli, 2007-2008) der Forschung unschätzbare Erkenntnisse liefern. Im Vortrag wird die sprachgeographische Distribution und chronologische Schichtung der slavischen Lehnwörter in albanischen Dialekten vorgenommen und analysiert.

HUAZIMET SLLAVE NË DIALEKTET E GJUHËS SHQIPE

Meqë tashmë është bërë më se i njohur inventari thuajse i plotë i huazimeve sllave në shqipe, falë kjo një numri të madh botimesh studimore (Miklosich, Jokl, Seliščev, Desnickaja, Çabej, Svane, Pešikan, Ylli, Orel etj.), fiton ndërkohë sërish terren problemi i hershëm i shtresimit të tyre kronologjik, semantik dhe gjeografik-gjuhësor, në rast se duam t'u përgjigjemi kështu pyetjeve, se ku dhe kur saktësisht, prej cilit dhe në ç'rrethana e cilat sllavizmat, përkatësisht në cilat dialekte shqipe kanë depërtuar ato. Kështu p.sh., për të dalluar shtresën më të hershme të huazimeve prej shtresave më të reja, duhen marrë parasysh krahas kritereve fonetike edhe ato areale, si edhe duhen veçuar sllavizmat me shtrirje rajonale prej atyre mbarëdialektore shqipe. Këtu mund të ofrojnë njohje të pallogaritshme qoftë gjuhësia ballkanike ashtu edhe gjeografia gjuhësore moderne albanologjike (Gjinari J., Beci B., Shkurtaç

Gj., Gosturani Xh., Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe. bl. I, II. Napoli, 2007-2008). Në kumtesë do të shqyrtohet dhe analizohet përhapja gjeografiko-gjuhësore dhe shtresimi kronologjik i huazimeve sllave në dialektet shqiptare.

* * *

Asz. Prof. Dr. Anila Omari
(QSA Tirana)

DIE SLAWISMEN IN DER ALTLITERATUR IM NORDALBANISCHEN KULTURAREAL (15.-17. JH.)

Das slavische Element im Albanischen stellt eine wichtige Schicht seines lexikalischen Reichtums dar, sowohl vom Umfang, als auch von der Bedeutung her, die sie innerhalb des albanischen Wortschatzes behaupten kann. Der slawische Einfluss auf das Albanische zeichnet sich durch bestimmte Besonderheiten aus, die sich von den anderen Sprach- und Kultureinflüssen des Albanischen unterscheiden: geographisch ist er nicht gleichmäßig im gesamten albanischsprachigen Raum vertreten; kulturell hat er nur bestimmte Bereiche des sozialen und ökonomischen Lebens erfasst, und im Hinblick auf die Herkunft, gehört er den zwei großen südslawischen Sprachgruppen an: dem östlichen und westlichen Balkanslawisch. Wegen dieser Besonderheiten haben die Forscher für die künftige Forschung der Albanologie die Bestimmung der geographischen Verbreitung der slawischen Lehnwörter in den albanischen Dialekten und die Aussonderung der Elemente mit eingeschränkter regionaler Verbreitung von denen des Gesamtalbanischen zur Aufgabe gemacht. Durch die Arbeiten von Desnickaja, Çabej, Svane, Ylli und der Autorin dieses Vortrags, und nicht zuletzt dank der Ergebnisse der Feldforschung zur Aufzeichnung und Verifikation der Lehnwörter slawischen Ursprungs in der Kartothek des Albanischen Wortschatzes (QSA), verfügen wir nun über ein klares Bild der Verbreitung der slawischen Lehnwörter in der albanischen Dialektlandschaft bzw. im gesamten albanischsprachigen Raum.

Dieses Bild spiegelt den heutigen Zustand der Verbreitung der Slawismen im Albanischen wider. Für eine Chronologie der slawischen Lehnwörter im Albanischen haben wir jedoch keine genauen Daten. In diesem Bereich kommt uns die Erforschung der Slawismen in den altalbanischen Texten zu Hilfe. Auch für Lexeme, die heute im gesamten Sprachgebiet vorkommen, können uns die alten nordalbanischen Texte Auskunft zum Ursprung des Gebrauchs eines Wortes in einem der zwei Hauptdialekte des Albanischen geben, das sich später durch die Standardsprache verbreitet hat. Interessante Angaben finden wir auch zur Semantik der Slawismen im Altalbanischen, wo wir durch den Vergleich zum heutigen Sprachzustand die Bedeutungsentwicklung, die ein Wort im Laufe der Zeit erfahren hat, verfolgen können. Die Präsenz eines slawischen Lehnworts bei allen alten Autoren ist ein Beweis für die Verankerung des Lexems in der albanischen Sprache und vor allem in der Standardsprache, als Kriterium, um Elemente des gesamten Sprachraums von Regionalen zu unterscheiden.

Die Verbreitung und die Wichtigkeit der Slawismen bei bestimmten altalbanischen Autoren folgt im Allgemeinen denen von Slawismen im gesamten albanischen Sprachraum: in den Randgebieten ist der slawische Einfluss intensiver und verblasst in Richtung des Landesinneren. Autoren, die aus den peripheren Gegenden stammen, (heute sogar außerhalb der Grenzen des albanischen Staates, wie Buzuku und Bogdani, Ersterer wahrscheinlich aus dem Umkreis von Ulqin, der andere aus der Gegend von Prizren), verwenden eine größere Anzahl von Slawismen als Budi und Bardhi, (ersterer aus Mati in Nord-Mittelalbanien, der andere aus Zadrime im Süden von Shkodra). Die Slawismen, die nur bei Buzuku auftreten, sind ungefähr 19 Einheiten. Bogdani verwendet 20 lexikalische Einheiten slawischer Herkunft, die sich nicht bei den anderen Autoren finden. Budi und Bardhi haben jeweils drei exklusive Slawismen. Die Anzahl der Slawismen, die bei den vier altalbanischen Autoren auftreten, erreicht 24 Einheiten. Die anderen Slawismen finden sich bei zumindest zwei von ihnen. Insgesamt beträgt die Zahl der bei allen altalbanischen Autoren auftretenden Slawismen rund 100 Einheiten. Diese relativ begrenzte Anzahl von Slawismen in den altalbanischen Texten hängt in erster Linie mit der überwiegend geistlichen und Gelehrthematik dieser Texte zusammen. Hingegen erfassen die Slawismen des Albanischen semantische Bereiche, die mehr mit dem Landleben und der Organisation der mittelalterlichen Feudalverwaltung verbunden sind. Die geistliche Terminologie im Albanischen hat bekanntlich keine slawische Herkunft.

Unter den Slawismen der altalbanischen Texte befinden sich Lexeme aus dem Bereich der mittelalterlichen Feudalverwaltung (bashtinë, ban, bujar, i begatë, beleg, carinë, gjobë,

kamatë und kamatnik, leçit, opqinë, padit, penez, rend, rob, starisfat, shtrazë, vojshtinë, vojvodë, zakon). Ein Teil davon wird heute nicht mehr gebraucht. Die anderen sind Teil des gesellschaftlichen und landwirtschaftlichen Wortschatzes, der Umwelt, des täglichen Lebens usw.

SLLAVIZMAT NË SHQIPEN E AUTOREVE TË VJETËR TË VERIUT (SHEK. XV-XVII)

Elementi me origjinë sllave në shqipen përbën një shtresë të rëndësishme të pasurisë leksikore të saj, si për nga vëllimi, ashtu dhe nga pesha që mban brenda leksikut të shqipes. Ndikimi sllav në shqipen ka disa specifika që e dallojnë nga ndikimet e gjuhëve e kulturave të tjera në shqipen: gjeografikisht ai nuk është ushtruar njëtrajtësisht në gjithë territorin e shqipes, kulturalisht ai ka përfshirë sfera të caktuara të jetës shoqërore e ekonomike dhe, në pikëpamje të prejardhjes, u përket dy grupeve të mëdha të gjuhëve sllavo-jugore: sllavishtes ballkanike lindore dhe asaj përqendimore. Për arsye të këtyre veçorive, studuesit, që nga Jokli së pari, kanë shtruar si detyrë për studimet e ardhshme albanologjike përcaktimin e përhapjes gjeografike të huazimeve sllave në dialektet e shqipes dhe dallimin e elementeve me përhapje të kufizuar krahinore nga ato të mbarë gjuhës. Me punimet e Desnickajas, Çabejt, Svanes, Yllit dhe autores së kumtesës, falë kërkimeve në terren krahas verifikimit të materialit me burim sllav në Kartotekën e Leksikut të Shqipes, ne kemi sot një tablo të qartë të shpërndarjes së huazimeve sllave nëpër dialektet e shqipes dhe në mbarë territorin e shqipes.

Gjithsesi tabloja pasqyron gjendjen e sotme të shpërndarjes së sllavizmave në shqipen. Për një kronologji të huazimeve sllave në shqipen ne nuk kemi të dhëna të sakta. Në këtë drejtim na vjen në ndihmë hulumtimi i sllavizmave në tekstet e vjetra shqipe. Gjithashtu për leksema që sot paraqiten me përhapje në mbarë gjuhën, tekstet e të vjetra të Veriut mund të na japin të dhëna për zanafillën e përdorimit të fjalës në njërin nga dy kryedialektet e shqipes, e cila më vonë është përhapur nëpërmjet gjuhës letrare. Të dhëna me interes gjejmë edhe për semantikën e sllavizmave në shqipen e vjetër, ku nëpërmjet krahasimit me gjendjen e sotme mund të ndjekim zhvillimin kuptimor që ka pësuar fjala gjatë rrjedhës së kohërave. Prania e një huazimi sllav në të gjithë autorët e vjetër është edhe një dëshmi për ngulitjen e leksemës në gjuhën shqipe dhe veçanërisht në gjuhën letrare, si kriter për të dalluar elementet e mbarë gjuhës nga ato krahinore.

Përhapja dhe pesha (rëndësia) e sllavizmave në autorë të veçantë të shqipes së vjetër ndjek në vija të përgjithshme ato të sllavizmave në shqipen e përgjithshme: në zonat skajore ndikimi sllav është më intensiv dhe vjen duke u zbehur drejt brendësisë së vendit. Autorët me prejardhje nga trevat periferike, madje sot jashtë kufijve të Shqipërisë zyrtare, si Buzuku e Bogdani, i pari me gjasë nga rrethinat e Ulqinit, i dyti nga rrethet e Prizrenit, përdorin një numër më të madh sllavizmash sesa Budi e Bardhi, i pari nga Mati, në Shqipërinë Veriqendrore, i dyti nga Zadrime në jug të Shkodrës. Sllavizma që dalin vetëm te Buzuku janë rreth 19 njësi. Bogdani përdor 20 njësi leksikore me burim sllav që nuk gjenden te autorët e tjerë. Budi e Bardhi kanë nga 3 sllavizma ekskluzivë. Numri i sllavizmave që dalin në të katër autorët e vjetër të Veriut arrin pra në 24 njësi. Sllavizmat e tjerë gjenden te të paktën dy prej tyre.

Sllavizmat në të gjithë autorët e vjetër arrijnë në shifrën rreth 100 njësi. Numri relativisht i kufizuar i sllavizmave në tekstet e vjetra shqipe lidhet në radhë të parë me tematikën kryesisht fetare e diturore të këtyre teksteve, ndërkohë që sllavizmat e shqipes përfshijnë fusha semantike që lidhen më tepër me jetën fshatare dhe organizimin administrativ feudal-mesjetar. Terminologjia fetare në shqipe siç dihet nuk ka prejardhje sllave.

Ndër sllavizmat e teksteve të vjetra shqipe hyjnë leksema nga fusha e administrimit feudal mesjetar (bashtinë, ban, bujar, i begatë, beleg, carinë, gjobë, kamatë e kamatnik, leçit, opqinë, padit, penez, rend, rob, starisfat, shtrazë, vojshtinë, vojvodë, zakon), një pjesë e të cilave sot kanë dalë nga përdorimi. Të tjera bëjnë pjesë në fusha të leksikut social, bujqësor, të mjedisit, jetës së përditshme etj.

* * *

Dr. Larisa Kaminskaja
(Universität St. Petersburg)

GJUHA SHQIPE NË LEKSIKOGRAFINË RUSE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XVIII

Objekt i kësaj kumtese është paraqitja e disa të dhënave rreth historisë së krijimit të fjalorëve të parë shumëgjuhësh në Rusi në shek. XVIII që nisi me inisiativë të perandoreshës Katerina e Dytë dhe nën drejtimin e Pallasit dhe të Jankoviçit. Vlera e këtyre fjalorëve për albanologjinë konsiston në shfrytëzimin e materialit të gjuhës shqipe si pjesë përbërëse e këtyre fjalorëve. Studimet tona të mëtejshme arkivore që kanë të bëjnë me dorëshkrime e letërkëmbime që janë ruajtur në Sektorin e Dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare Ruse të Shën-Peterburgut hedhin dritë mbi historinë e mbledhjes së materialit gjuhësor shqip për këta fjalorë.

DIE ALBANISCHE SPRACHE IN DER RUSSISCHEN LEXIKOGRAPHIE IN DER ZWEITEN HÄLFTE DES 18. JH.S

Gegenstand dieses Beitrags ist die Darstellung mehrerer Daten zur Geschichte der Entstehung der ersten mehrsprachigen Wörterbücher in Russland des 18. Jh.s, deren Anfänge bei der Initiative der Kaiserin Katerina II. und der redaktionellen Arbeit von Pallas und Jankovic zu suchen sind. Die Bedeutung dieser Wörterbücher für die Albanologie bezieht sich auf die Ermittlung des albanischen Sprachmaterials, das bei der Erfassung dieser Wörterbücher mitberücksichtigt worden ist. Unsere weiteren Untersuchungen der Handschriften, der Korrespondenzen, die in der Handschriftenabteilung der russischen Nationalbibliothek von Sankt Petersburg aufbewahrt werden, werden ein Licht auf die Geschichte der Sammlung des albanischen Sprachmaterials für diese Wörterbücher werfen.

* * *

Dr. Lumnije Jusufi
(LMU München)

HISTORISCHE MIGRATIONEN IM SPIEGEL DER DIALEKTLANDSCHAFT VON MANASTIR

Manastir (maz. Bitola) liegt im Süden Mazedoniens. Der heutige Verfall dieser alten Stadt und die äußerst spärlich besiedelte rurale Umgebung lassen nicht im Geringsten erahnen, welche Funktion und Bedeutung diese Gegend bis Mitte des 20. Jh. gehabt hat. Die Stadt hat heute gänzlich den Charakter einer Grenzregion. Zeugen der historischen Wichtigkeit dieses früheren Ballungsraums sind nicht nur die naheliegende antike Siedlung *Heraclea Lyncestis*, sondern auch die zahlreichen osmanischen Steuerregister des Mittelalters, die von einer gewaltigen Urbanisierung der Stadt berichten.

Die Umgebung von Manastir weist heute das typische mazedonische Charakteristikum, die bunte ethnische Zusammensetzung, in seiner stärksten Ausprägung auf. Manastir ist nicht nur hinsichtlich der religiösen und sprachlichen Zugehörigkeit heterogen zusammengesetzt, sondern auch dialektal, was das Albanische angeht. Im Norden der Stadt, mit dem südlichsten Punkt Obednik und Drevenik, finden sich Mundarten, die (nicht-zentral)gegisch sind. Südlich von Manastir ist das zentralgegische Dorf Ostrec gelegen. Die sonstige Umgebung von Manastir ist toskischen Dialekts, ebenso die Stadt selbst bis kurz nach dem Zweiten Weltkrieg. Heute ist die Stadt in jeder Hinsicht heterogen zusammengesetzt.

Dieses ethnisch-dialektale Mosaik verdankt seine Entstehung vielen Faktoren außersprachlicher Natur, darunter Faktoren geographischer (zahlreiche umliegende Wälder, Bestandteil von Pellagonia), infrastruktureller (wichtige Station an der Via Egnatia), wirtschaftlicher (urbanes Zentrum auch für die Gegenden von Kërçova, Kruševo und sogar Dibër), administrativer (Zentrum des Sandschak von Manastir) und bildungspolitischer Art (Sitz der zweiten Militärakademie des Balkans im 19. Jh. und Tagungsort des albanischen Alphabetkongresses).

Demnach stellte Manastir historisch eines der wichtigsten urbanen Zentren des Westbalkans dar. Es war Anziehungspunkt für die ländliche Bevölkerung aller Ethnien und somit auch der albanischsprachigen Bevölkerung. Sein Wirkungskreis reichte sogar bis nach Dibër und

Mittelalbanien hinein. Dies belegen zahlreiche Anthroponyme schon zu Beginn des 16. Jahrhunderts mit Herkunftsinhalt aus Dibër. Informanten aus Ostrec geben ebenfalls an, der Ursprung dieses Dorfes sei in der Region von Dibër. Einige Familien aus Presill stammen sogar aus Librazhd. Manastir wurde ab dem 18. Jh. Residenz von vielen reichen Familien aus Korça.

Der Vortrag versucht, die Relevanz dieser historischen Migrationsbewegungen aus ruralen und kleinstädtischen Gegenden Mazedoniens und Mittelalbaniens (Korça und Dibër) für die heterogene dialektale Zusammensetzung der Region von Manastir zu untersuchen. Neben den o. g. osmanischen Quellen aus dem Spätmittelalter stellen empirische Datenerhebungen vor Ort aus den Jahren 2009 und 2011 die Basis des Vortrags.

PASQYRIMI I MIGRACIONEVE HISTORIKE NË AREALIN DIALEKTOR TË MANASTIRIT

Manastiri (maq. Bitola) gjendet në jug të Maqedonisë. Rrëgjimi i sotëm i këtij qyteti të vjetër me rrethinat rurale shumë pak të banuara nuk lejojnë të merret me mend se çfarë roli dhe rëndësie ka pasur kjo trevë deri në mes të shek. 20-të. Në kohën tonë qyteti përjeton karakterin e një zone kufitare. Dëshmi për rëndësinë historike të këtij rajoni dikur me popullsi të konsiderueshme nuk përcjell vetëm vendbanimi antik Heraclea Lyncestis pranë Manastirit, por edhe regjistrat e shumtë kadastralë osmanë të Mesjetës, të cilët na kumtojnë informacione për një urbanizim të fuqishëm të qytetit.

Rrethina e Manastirit pasqyron sot më së qarti karakteristikën tipike maqedonase, përzierjen e larmishme etnike të vendit. Manastiri nuk karakterizohet vetëm për nga përbërja heterogjene e përkatësisë fetare dhe gjuhësore, por edhe për vetë larminë dialektore të të folmeve shqipe. Kështu p.sh. në veri të rajonit, bash në pikat më jugore si Obednik dhe Drevenik gjëllin të folme geqe (jo qendrore). Në jug të Manastirit ndodhet fshati Ostrec me të folmen e vet geqe qendrore. Përndryshe, në pjesën tjetër të zonës së Manastirit ndeshim të folme të dialektit toskë, sikurse edhe vetë qyteti deri në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Në kohën tonë qyteti na paraqitet heterogjen nga çdo këndvështrim.

Ky mozaik etnik e gjuhësor-dialektor është përfutur falë veprimit të shumë faktorëve jashtëgjuhësorë, ndër të tjerë: syresh të karakterit gjeografik (zonë e rrethuar me pyje të shumtë si pjesë përbërëse e Pellagonisë), infrastrukturor urban (stacion i rëndësishëm në rrugën Via Egnatia), ekonomik (qendër urbane edhe për rajonet e Kërçovës, Krushevës, madje edhe të Dibrës), administrativ (qendër e Sanxhakut të Manastirit) si edhe politik-arsimor (seli e akademisë së dytë ushtarake të Ballkanit në shek. 19-të dhe vendi ku u tubua Kongresi i Alfabetit shqiptar).

Pra Manastiri ka qenë një ndër qendrat më të rëndësishme urbane të Ballkanit Perëndimor me një forcë tërheqëse për popullsinë rurale e të gjitha etnive e për rrjedhojë edhe për bashkësinë etnike shqipfolëse. Qerthulli i ndikimit të tij arrinte madje deri në Dibër dhe në Shqipërinë e Mesme. Për këtë dëshmojnë antroponime të shumta qysh prej fillimit të shek. 16-të me shenjues burimorë të zonës së Dibrës. Informantë nga Ostreci mëtojnë se fshati i tyre e ka gurrën e vet në rajonin e Dibrës, ndërsa disa familje nga Presilli e kanë origjinën nga zona e Librazhdit. Manastiri në shek. 18-të u bë seli e shumë familjeve të pasura nga Korça.

Kumtesa synon të hulumtojë rëndësinë e lëvizjeve të migracionit historik nga zonat rurale dhe qytetet e vogla të Maqedonisë dhe të Shqipërisë së Mesme (Korçë dhe Dibër) që kanë ndikuar përbërjen heterogjene dialektore të rajonit të Manastirit. Studimi mbështetet në burimet osmane të periudhës së mesjetës së vonë si edhe në materialin e mbledhur në terren gjatë ekspeditave të kryera në vitet 2009 dhe 2011.

4. SESSION: 17.00 - 18.30 Uhr

Prof. Dr. Francesco Altimari
(Università Cosenza)

ANALISI DI ALCUNI MANOSCRITTI CON TESTI E LESSEMI SULL' ALBANESE DELL' ISTRIA

La comunicazione riguarda l'analisi di alcuni manoscritti sull'albanese dell'Istria che risalgono agli anni '30 del XIX secolo, opera di Pietro Stancovich/Petar Stanković (1771-1851), originario

di Barbana d'Istria, considerato il padre della lessicografia istriana. Si tratta della versione albanese della parabola del figliol prodigo e di una breve lista di lemmi che rispecchiano l'albanese che veniva parlato ancora in quel periodo a Parenzo, altra località istriana di lingua e cultura veneta oggi rientrate nei confini amministrativi della Repubblica di Croazia, ma all'epoca sotto dominazione austriaca.

ANALIZA E DISA DORËSHKRIMEVE ME TEKSTE DHE LEKSEMA PËR SHQIPEN E ISTRJES

Kumtesa ka të bëjë me analizën e disa dorëshkrimeve për shqipen e Istriës që datojnë në vitet '30 të shekullit XIX, dhe që janë shkruar nga Pjetër Stankoviç (1771-1851), me origjinë nga Barbjana e Istrjes dhe që konsiderohet si ati i leksikografisë istriane. Bëhet fjalë këtu për versionin shqip të parabolës së Djalit plangprishës dhe për një listë të vogël lemmash që pasqyrojnë shqipen e folur ende në atë kohë në Parenco (kroatisht Poreč), një qytezë e Istriës me gjuhë dhe kulturë veneciane që sot bën pjesë në Republikën e Kroatisë, por që asokohe ishte nën sundimin e Perandorisë austro-hungareze.

* * *

Dr. Aleksander Murzaku

(Coll. S. Elizabeth/USA)

FINDING PATTERNS IN TEXTS: A QUANTITATIVE ANALYSIS OF QUALITATIVE LANGUAGE CHANGES

This paper presents various experiments in the text computational analysis focused on finding patterns of language change in general, and stylistic differences among authors, or differences among writings of the same author in various periods.

According to Coseriu (1997:31) language is a universal activity exercised individually while observing historical norms. In this definition can be identified a universal level, a historical level and the level of text (realized in either written or spoken forms). Following this premise, we will observe Albanian language realized in texts written by Kadare in two different realities. Even though Kadare's characteristic style has always allowed an ambiguous reading and understanding (Champseix, 2006), his actual choice of words has changed according to the period in which he wrote. The two analyzed texts are *Koncert në fund të dimrit* 'The Concert at the End of Winter' (1988) and *Lulet e ftohta të marsit* 'Spring Flowers, Spring Frost [literally The Cold Flowers of March]' (2000) representing writings before and after 1990. From now on, we will refer to these two books as *Koncert* and *Lulet*.

The approach taken in analyzing the two texts from Kadare is based on what sometime is called computational stylistics. Quantitative analysis will detect the influence of social changes in Kadare's literary work. The effects can be recognized in the deviations from the norms of language use. Albanian language norms are extracted from a large 25 million word corpus of various texts. Every writer selects and combines words differently, so much so that sometime the result is considered as a literary fingerprint. It is possible that - while maintaining writer's uniqueness - these fingerprints change according to the reality in which the writer operates. By investigating these differences it can be assessed how reality affects the writer.

As Argamon et al. (2007) show, reducing statistical stylistic analysis to the usage of only function words - as it is often tried - seems unsatisfying, as these words rarely give good insight into underlying stylistic issues. According to the category of discrimination they are trying to achieve (books from the same author or language varieties from different continents), the proposed features are expanded and they are computed in various combinations.

Another approach is that of semantic prosody defined as a consistent aura of meaning with which a form is imbued by its collocates (Louw, 1993). In this case it is the changes in the aura - the meaning of the words - that are analyzed. From this point of view, supporting Wittgenstein's assertion that we give words meaning by explanation (Wilks et al. 1996:43), the meaning of a word or expression resides in the relation to other words and expressions. These two ways of looking at text convey not only the way the writer reflects a new reality but also how words are combined and what meaning is given to them by any new collocations that start to appear.

The goal of the statistical analysis described in this paper is twofold: first, to identify words that are more typical for an author or the period in which the texts are written; second, finding how the meaning of words is modified with the changes in the reality in which the author of the analyzed texts lives.

Conclusions

As many taboos fell at the same time, as many new concepts are introduced, as is usual in times of revolution, language is reflecting these profound changes. In Labovian terms, we are faced with the phenomenon of *structural diffusion* between languages and dialects in contact caused by the sudden changes in Albanian reality. These sudden changes, according to Mioni's taxonomy, are caused by two kinds of catastrophic events. On one hand, Albania is faced with mass migrations: from villages to the cities with depopulation in the mountainous areas and overpopulation in the areas around the capital, Tiranë and from Albania to other countries with a significant "brain drain." The sociopolitical and economic catastrophes include a new organization of government, the appearance of both nationalism and regionalism, and the re-legitimization of religion. The compressed timeline of these processes provides great laboratory observational conditions with insights on how languages change.

GJURMË NË TEKSTE: ANALIZË SASIORE E NDRYSHIMEVE CILËSORE NË GJUHË

Kjo kumtesë është rezultat i eksperimenteve që kam bërë këto vitet e fundit në analizën automatike të tekstit për të gjetur gjurmë të ndryshimeve të natyrshme në gjuhë në përgjithësi por edhe për të gjetur ndryshimet në mënyrën e të shkruarit midis autorëve të ndryshëm apo të të njëjtëve autorë në periudha të ndryshme.

Sipas Coseriu-t (1997:31), gjuha është një aktivitet universal i ushtruar individualisht duke respektuar njëkohësisht normat historike. Në këtë përkufizim mund të identifikohet një nivel universal, një nivel historik dhe niveli i tekstit (i realizuar si në formë të shkruar ashtu edhe në atë të folur). Duke ndjekur këtë premisë, ne do të vëzhgojmë gjuhën shqipe të realizuar në tekste të shkruara nga Kadare në dy realitete të ndryshme. Edhe pse stili karakteristik i Kdaresë e ka lejuar gjithmonë lexuesin të shohë më shumë se një kuptim në tekst (Champseix, 2006), zgjedhja e fjalëve nga ana e tij ka ndryshuar në bazë të periudhës në të cilën ai shkroi. Dy tekstet e analizuar janë "Koncert në Fund të Dimrit" (1988; tani e tutje Koncert) dhe "Lulet e ftohta të marsit" (2000; tani e tutje Lulet) që përfaqësojnë shkrime para dhe pas 1990-ës.

Këto dy tekste të Kdaresë janë analizuar duke ndjekur metoda që herë-pas-herë janë përmbledhur në termin "stilistikë kompjuterike." Analiza sasimore e tekstit do të përdoret për të zbuluar ndikimin e ndryshimeve shoqërore në veprën letrare të Kdaresë. Pasojat e këtij ndikimi mund të shihen në devijimin nga përdorimi i ashtuquajtur "normal" i gjuhës. I ashtuquajtur përdorim "normal" i gjuhës është deduktuar nga një korpus prej 25 milionë fjalësh të përdorura nëpër tekste të shumëllojshme. Çdo shkrimtar zgjedh dhe kombinon fjalët e tekstit të tij në mënyra të ndryshme: kaq të ndryshme janë këto përzgjedhje sa që paraqitja formale e këtij procesi është konsideruar si gjurmë gishtërinjsh të natyrës letrare. Teza jonë parashikon mundësinë që këto gjurmë gishtërinjsh ndryshojnë në përputhje me realitetin në të cilin operon shkrimtari. Duke hetuar këto dallime mund të vlerësohet se si realiteti ndikon në këtë aspekt të shkrimtarit.

Siç vërejnë Argamon et al. (2007), në qoftë se analizat statistikore stilistike fokusohen vetëm në përdorimin e fjalëve funksionale - siç është tentuar shpeshherë - rezultatet nuk duken aq premtuese. Arsyeja është se këto fjalë, rrallë reflektojnë aq sa duhet nënshtresat stilistike. Sipas llojit të dallimit që duam të zbulojmë nga këto analiza - p.sh. diferencat midis librave të të njëjtit autor apo identifikimi i varieteteve të gjuhës nëpër kontinente të ndryshme - numri i karaktereve që përfshihen në analizë shtohet apo pakësohet dhe përfshihen në modele të ndryshme.

Një përjasje tjetër e këtij problemi e njohur me emrin prozodi semantike përshkruhet si një kurore e qëndrueshme kuptimore që krijohet nga një grup fjalësh të bashkëpërdorura shpesh me fjalën e analizuar (Louw, 1993). Duke ndjekur këtë metodologji, ne vëzhgojmë ndryshimet në këtë kurorë, apo kuptimin e fjalëve që po analizohen. Nga kjo pikëpamje, duke mbështetur pohimin e Wittgenstein se ne i japim fjalëve kuptim duke i shpjeguar (Wilks et al. 1996:43), kuptimi i një fjale apo shprehjeje ndodhet në marrëdhëniet e saj me fjalë dhe

shprehje të tjera. Këto dy mënyra të të shikuarit të tekstit zbulojnë jo vetëm mënyrën se si shkrimtari pasqyron një realitet të ri, por edhe se si fjalët kombinohen dhe çfarë kuptimi marrin nga bashkëpërdorime të reja fillojnë të shfaqen.

Objekti i analizës statistikore të përshkruar në këtë kumtesë është i dyfishtë: së pari, të identifikojë fjalët që janë më tipike për një autor apo për periudhën në të cilën tekstet janë shkruar; së dyti, të zbulojë se si ndryshon kuptimi i fjalëve në paralel me ndryshimet në realitetin në të cilin autori jeton.

Konkluzione

Me rënien e menjëhershme të shumë tabuve, me hyrjen e shumë koncepteve të reja, gjë që është e zakonshme gjatë revolucioneve, gjuha gjithashtu i reflekton këto ndryshime të thella. Sipas terminologjisë Laboviane, në këtë rast kemi të bëjmë me fenomenin e difuzionit strukturor midis gjuhëve dhe dialekteve në kontakt - kontakte këto të shkaktuara nga ndryshime të papritura në realitetin shqiptar. Këto ndryshime të papritura, sipas taksonomisë së Mionit, janë shkaktuar nga dy lloje ngjarjesh katastrofike. Nga njëra anë, Shqipëria është përballur me migrimet masive: nga fshatrat në qytete, gjë që çoi në shpopullimin e zonave malore dhe mbipopullimin e zonave rreth kryeqytetit, Tiranë; dhe nga Shqipëria në vendet e tjera gjë që përfshiu edhe një "ikje domethënëse të trurit" apo "brain drain". Katastrofat sociopolitike dhe ekonomike përfshijnë një organizim të ri të qeverisë, rigjallërimin si të nacionalizmit ashtu edhe të krahinizmit, dhe ri-legjitimimin e fesë. Ngjeshja në kohë e këtyre proceseve ofron kushte laboratorike optimale për të vëzhguar nga afër se si gjuhët ndryshojnë.

* * *

Besim Kabashi MA

(Universität Erlangen)

EIN VALENZLEXIKON FÜR DAS ALBANISCHE

Ein Valenzlexikon fehlt der albanischen Sprache noch. Es kann für viele Zwecke verwendet werden und ist unentbehrlich in vielen Bereichen. Ein solches Wörterbuch kann für Lehr-, Lern- und Korrekturzwecke, für eine Dokumentation der Sprache sowie für Zwecke der maschinellen Sprachverarbeitung verwendet werden – schließlich auch in der Forschung für die Spezifizierung und Präzisierung des sprachlichen Wissens.

Für die maschinelle Sprachverarbeitung werden Ressourcen gebraucht, die eine präzise Beschreibung der Sprache ermöglichen. Für das Albanische lässt der aktuelle Stand der vorhandenen Ressourcen vieles zu wünschen übrig. Es fehlen viele Ressourcen, etwa eine mit ausführlichen lexikalischen Informationen, sodass ein groß angelegtes Projekt schwierig umzusetzen wäre. In dieser Situation ist eine regelbasierte Behandlung der Sprache im Bereich der Syntax – der Fokus des Vortrages – unmöglich, denn dafür wird eine Morphologie-Komponente vorausgesetzt, ebenso wie weitere Ressourcen, welche auch fehlen. Eine sehr wichtige Ressource, die für eine Modellierung und folglich eine Implementierung einer automatisierten Syntax benötigt wird, sind Valenzinformationen in Form eines Valenzlexikons. Dadurch werden wichtige Eigenschaften der beteiligten Wörter im Satz beschrieben sowie die Eigenschaften der Sätze selbst. Ein Lexikon, das diese Aufgabe übernimmt, hat als Ziel zu den einzelnen Einträgen die entsprechende Information zu geben, genauer die Wertigkeit der Wörter (Art und Anzahl der Ergänzungen die sie brauchen und ähnliche Eigenschaften), sowie die Strukturen der Sätze in denen sie vorkommen, begleitet von Belegen (Beispielen) aus dem Korpus bzw. aus verschiedenen Texten. Es handelt sich in erster Linie um Verben, wobei mit den wichtigsten und verbreitetsten angefangen wurde, bspw. mit al. *ecë* (dt. *laufen*), al. *sheh* (dt. *sehen*), al. *flet* (dt. *sprechen*). Die Substantive und Adjektive sollen folgen.

In dem Vortrag wird das Konzept und die Arbeitsweise für die Erstellung des Valenzlexikons vorgestellt. In diesem Zusammenhang werden auch einige Beispiele aus dem Lexikon präsentiert, sowie einige der Schwierigkeiten bei der Erstellung der Einträge besprochen.

NJË FJALOR I VALENCËS PËR SHQIPEN

Një fjalor i valencës i mungon ende gjuhës shqipe. Ai mund të përdoret për shumë qëllime dhe është i nevojshëm dhe i pazëvendësueshëm në shumë fusha. Një fjalor i tillë mund të përdoret për qëllime mësimdhënieje, mësimnxënieje dhe korrigjimi, për qëllime dokumentimi të gjuhës

si edhe për qëllime të përpunimit teknologjik të gjuhëve natyrore - së fundmi në shkencë për të përkufizuar dhe saktësuar dijen gjuhësore.

Për përpunimin teknologjik të gjuhëve natyrore nevojiten resurse, të cilat mundësojnë një trajtim të saktë të gjuhës. Në rastin e shqipes gjendja e tanishme e resurseve ekzistuese lë shumë për të dëshiruar. Mungojnë shumë resurse, bie fjala një me informacione të mjaftueshme leksikore, sa që zbatimi i një projekti të madh do të ishte shumë i vështirë. Në këtë situatë trajtimi i bazuar në rregulla të gjuhës në fushën e sintaksës - fokusi i kumtesës - është i pamundshëm ngaqë për këtë është parakusht një komponente morfologjike, sikurse edhe komponentë të tjerë të cilët po ashtu mungojnë. Një resurs shumë i rëndësishëm, i cili duhet për modelimin dhe pastaj për implementimin e një sintakse të automatizuar, janë informacionet e valencës në formë të një fjalori të valencës. Me këtë përshkruhen d. m. th. përkufizohen shumë veçori të fjalëve pjesëmarrëse në fjali dhe cilësi të vetë fjalive. Një fjalor, i cili merr këtë detyrë, ka për qëllim që për secilin zë të fjalorit (d. m. th. fjalë të tij) të japë informacionin përkatës, saktësisht vlerën e fjalëve (llojet dhe numrin e plotësorëve që atyre u duhen e veçori të ngjashme), si dhe strukturën e fjalisë në të cilën ajo përdoret, shoqëruar me shembuj të nxjerrë nga korpusi, përkatësisht tekstet e ndryshme. Bëhet fjalë në radhë të parë për foljet, për ato më të rëndësishmet përkatësisht ato me përdorim më të shpeshtë, me të cilat ka filluar puna ndërkohë, b. fj. ecë, sheh dhe flet. Emrat dhe mbiemrat do të trajtohen pas foljeve.

Në kumtesë do të paraqitet koncepti dhe mënyra e punës për përpilimin e fjalorit të valencës. Me këtë rast do të tregohen edhe disa shembuj të fjalorit, si dhe do të flitet për disa vështirësi gjatë hartimit të zërave të tij.

2. Arbeitstag: Samstag, den 24. Juni 2011

5. SESSION: 09.00-11.00 Uhr

Prof. Dr. Rexhep Ismajli
(ASHAK, Prishtina)

BUZUKIANA MONACENSIA: CAMAJ-FIEDLER

Fjalët çelësa: Camaj, Fiedler, studimet buzukiane, palimpsesti, kategoritë funksionale-semantike të kohës, të aspektualitetit, të mënyrës, sistemi gramatikor i shqipes

Historia e studimeve të organizuara albanistike në Munih nis me M. Camajn dhe vijon me W. Fiedlerin e të tjerë, sado që qarqet shkencore të kësaj hapësire kishin shfaqur interesa për botën shqiptare, gjuhën, kulturën dhe të kaluarën e saj edhe më parë dhe jashtë këtyre studimeve. Martin Camaj po vinte në Munih me mësimet kryesisht në vijën e krahasimeve junggramatikane të H. Bariçit që kishte marrë në Beograd më parë, të zgjeruara më tej me aspektet kulturore e filologjike, por edhe të lingistikës me të re në Romë. Në Munih ai po sillte edhe frymën e studimeve buzukiane si përvojë tashmë të kaluar të brezave të mëparmë - Rrota, pastaj Ressuli-Cabej-Riza, bashkë me raportin personal të tij të ndjeshëm në hulumtimin e grafisë dhe të tekstologjisë, të historisë së botimit dhe të librit, të gjuhës së Buzukut dhe të ndikimeve eventuale kulturore e gjuhësore nga gjuhët sllave përreth dhe përvojat kroate të përshtatjes së mesharëve e leksionarëve në gjuhën e tyre popullore në basenin venedikas të Adriatikut, siç do ta quante Camaj. Kur erdhi në Munih ai të gjitha këto tashmë i kishte lënë prapa të botuara si përvojë romane, ndërsa në interesimet e tij për gjuhën shqipe, po edhe buzukiane, hulumtimet kishin marrë rrugë të tjera të ndërlidhura dhe me interesimet e tij letrare: ato po rrëshqitnin drejt hulumtimeve gjuhësore më specifike strukturore e historike e sinkronike areale, në një anë, dhe drejt tematizimeve dhe hulumtimeve letrare të identitetit kulturor, të rrënjëve: tematizime të ndryshme buzukiane do të ndeshen në poezinë e tij, ndërsa historia e hulumtimeve për palimpsestet, që kishte nxitur tek ai kërkimi për Buzukun dhe historinë eventuale të shkrimit të shqipes më herët, vjen e bëhet tani strumbullar i tematizimeve letrare-poetike.

W. Fiedler në München erdhi me rrugë po ashtu tashmë të formuar prej hulumtuesi në fushën e studimeve gramatikore të shqipes dhe të gjuhëve të Ballkanit dhe pasi kishte mbaruar Camaj. Gjithë duke njohur historinë e tematizimeve palimpsesitane të Camajt, ai vijoi me interesimet e tij buzukiane në vijën e vet krejt të ndryshme: në vijën e shqyrtimeve rrënjësore

të gjuhës së përdorur në veprën e Buzukut duke marrë shkas në sistemin e saj foljor. Hulumtimet e tij në tri shtyllat funksionale-semantike të foljeve të shqipes - të kohës, të aspektualitetit dhe të mënyrës, sado që të para në mënyrë specifike në tekstin e Buzukut, madje me të gjitha imtësitë filologjike, do të jenë objekti themelor i studimeve të tij për strukturën e shqipes dhe funksionimin e saj. Interesimet ballkanistike do ta shpiten atë më tej, madje edhe drejt shqyrtimeve tipologjike. Kështu edhe një herë Buzuku dhe tekstet e vjetra shqipe në përvojën monacensiane do ta shpiten studiuësin e tyre përtej dhe më larg se vetë tekstet e vjetra shqip.

Studimet e teksteve të vjetra në Munich do të jenë objekt interesimi edhe tek pasardhësit e këtyre studiuësve të shquar, por me orientime e synime të tjera. Aspekte të tilla të studimeve buzukiane do të jenë objekt i këtij vështrimi.

BUZUKIANA MONACENSIA: CAMAJ-FIEDLER

Schlüsselwörter: *Camaj, Fiedler, Studien über Buzuku, Palimpsest, funktional-semantische Kategorien des Tempus, der Aspektualität, des Modus, das grammatische System des Albanischen*

Die Geschichte der systematischen albanologischen Studien in München beginnt mit Martin Camaj und setzt sich mit W. Fiedler und anderen Sprachforschern fort, obgleich innerhalb der wissenschaftlichen Kreise dieses Raums das Interesse über die albanische Welt, ihre Sprache, Kultur und ihre Vergangenheit schon früher auch außerhalb dieser Studien bestand. Martin Camaj kam nach München mit dem Wissen auf der vergleichenden junggrammatischen Linie von H. Barić, das er sich zuvor in Belgrad angeeignet hatte und in Rom kulturellen und philologischen Aspekten, aber auch Kenntnissen der neuesten Linguistik erweiterte. Nach München brachte er auch den buzuk'schen Forschungsgeist als eine von vergangenen Generationen gemachte Erfahrung - Rrota, dann Ressuli-Çabej-Riza, zusammen mit seiner persönlichen empfindlichen Verbindung zu den Studien der Graphie und Textologie, der Druck- und Buchgeschichte, der Sprache von Buzuku und der eventuellen kulturellen und sprachlichen Einflüssen aus den benachbarten slavischen Sprachen und den kroatischen Erfahrungen in Bezug auf die Anpassung der Mess- und Lehrbücher an die eigene Volkssprache in dem venezianischen Adriabecken, wie Camaj es später nennen wird. Als er nach München kam, hatte er all diese Dinge bereits hinter sich gelassen, veröffentlicht als romanistische Erfahrung, während seine Interessen und Studien bezüglich der albanischen Sprache, aber auch in Bezug auf Buzuku, eine andere mit seinen literarischen Interessen eng gekoppelten Richtung eingeschlagen hatten: sie glitten gen spezifischen strukturellen, historischen und arealsynchronen Sprachstudien auf der einen Seite hin, und gen literarischen Thematisierungen und Studien der kulturellen Identität, der Wurzel: verschiedene buzuksche Thematisierungen werden in seinen Gedichten anzutreffen sein. Dagegen wird die Geschichte der Nachforschungen über Palimpsest, das bei ihm die Nachforschungen über Buzuku und über eine mögliche frühere Schrifttradition des Albanischen angeregt hatten, mit der Zeit immer zentraler in Bezug auf die literarisch-poetischen Thematisierungen.

W. Fiedler kam nach München mit einer nun gereiften Ausbildung eines Forschers auf dem Gebiet der grammatischen Studien des Albanischen und der Balkansprachen als Camaj seine Tätigkeit beendet hatte. Indem er die ganze Geschichte der palimpsestianischen Thematisierungen von Camaj kannte, setzte er mit seinen auf Buzuku bezogenen Interessen seine eigene andersartige Linie fort: auf der Linie der tiefgreifenden Untersuchungen der im Buzukus Werk gebrauchten Sprache am Beispiel ihres Verbalsystems. Seine Untersuchungen im Bereich der drei funktional-semantischen zentralen Richtungen der albanischen Verben - des Tempus, der Aspektualität und des Modus, auch wenn es Anfänge in spezifischer Art des Textes von Buzuku waren, sogar mit allen philologischen Feinheiten, werden sie sein zentrales Forschungsobjekt über die Struktur und Funktionierung des Albanischen sein. Seine balkanologischen Interessen werden ihn weiter bringen, sogar auch gen typologische Studien. So sollten Buzuku und die altalbanischen Texte in der monacensianischen Erfahrung ihren Forscher weiter als die altalbanischen Texte selbst.

Die Forschung der alten Texte in München wird auch bei den Nachfolgern dieser hervorragenden Forscher zentrales Forschungsobjekt sein, aber mit anderen Orientierungen und Zielsetzungen. Derartige Aspekte der Studien zu Buzuku werden Objekt dieser Betrachtung sein.

* * *

Dr. Joachim Matzinger
(Universität Wien)

**DIE HEILIGENFESTE, ODER WIE SICH DAS PROPRIUM DE SANCTIS UND
DAS COMMUNE SANCTORUM IM SEELSORGEHANDBUCH DES GJON
BUZUKU (1555) DARSTELLEN**

Während die Sprache des ersten gedruckten Buchs des Albanischen, des Seelsorgehandbuchs des Gjon Buzuku von 1555 Gegenstand zahlreicher linguistischer Untersuchungen war, wurde dagegen sein innerer Aufbau, d.h. seine Komposition und die in ihm enthaltenen liturgischen und katechetischen Texte bis heute kaum ernsthaft beachtet. So zeigt sich nämlich, dass dieses Buch entgegen der traditionellen Bezeichnung als "Missale" vielmehr eine Kompilation verschiedener, vor allem liturgischer Texte darstellt, die der praktischen Seelsorge dienen. Die in Buzukus Buch zusammengestellten Texte machen es zu einem einzigartigen und unverwechselbaren Exemplar. Gerade aber die Frage nach den jeweiligen Inhalten und ihrem Aufbau kann unter Umständen vielleicht auch Antworten geben auf einige Fragen, die mit der Entstehungsgeschichte dieses Buches verbunden sind. Als ein erster Schritt zu einem besseren Verständnis der Inhalte werden daher der Aufbau des Proprium de Sanctis, des Commune Sanctorum sowie der Motivmessen vorgestellt werden. Aus deren Aufbau und Gestaltung in Buzukus Buch sollen sodann im Vergleich mit zeitgenössischen liturgischen Büchern Rückschlüsse eben auf die Entstehungsgeschichte des Buches gezogen werden.

**FESTAT E SHENJTA OSE SI PARAQITEN NË DORACAKUN E
PËRKUJDESIT SHPIRTËROR TË GJON BUZUKUT (1555) PROPRIUM DE
SANCTIS DHE COMMUNE SANCTORUM**

Ndërsa gjuha e librit të parë të botuar në shqip, ajo e Mesharit të Gjon Buzukut që datohet në vitin 1555, ka qenë gjithherë subjekt i shumë hulumtimeve gjuhësore, struktura e e tij e brendshme, d.m.th. përbërja e tij dhe tekstet liturgjike dhe katekiste që përfshihen në të, nuk janë shqyrtuar ende deri sot me seriozitetin e nevojshëm shkencor. Të bie në sy p. sh., që ky libër në kundërshtim me emërtimin tradicional "Meshar" ngërthen më fort një kombinim tekstesh të ndryshme, kryesisht liturgjike, të cilat i shërbejnë praktikave të përkujdesjes shpirtërore. Tekstet e përfshira në librin e Buzukut e dallojnë atë si një ekzemplar unik dhe të pandërrueshëm në llojin e vet. Por pikërisht çështja e përmbajtjeve përkatëse dhe e strukturës së tyre mund t' u japë përgjigje, në rrethana të caktuara, disa pyetjeve, që kanë të bëjnë me historinë e përfuturit të këtij libri. Andaj, si një hap i parë për të kuptuar më mirë këto përmbajtje, do të prezantohet struktura e Proprium de Sanctis, më tej e Commune Sanctorum si edhe Meshat Votive. Nga struktura dhe organizimi i tyre në librin e Buzukut në përfaqje me librat liturgjike të kohës duhet të nxjerrim përfundime mbi historinë e përfuturit të librit.

* * *

Prof. Dr. Mateo Mandala
(Universität Palermo)

SUL DIZIONARIO ETIMOLOGICO INEDITO DI MARCO LA PIANA

Il contributo scientifico di Marco La Piana alla linguistica storica albanese è nota agli albanologi e agli specialisti. Noto è anche il fatto che Egli lasciò inedite due corpose opere, una grammatica storica e un dizionario etimologico, i cui manoscritti si conservano presso il seminario Greco Albanese di Piana degli Albanesi. Meno noto è, invece, il fatto che di quei manoscritti si interessarono verso la fine degli anni '80 i proff. Antonino Guzzetta e Martin Camaj, che richiesero all'Eparca del tempo di affidarli alle loro cure per predisporre la pubblicazione e onorare così la memoria del loro Autore. Gli eventi, purtroppo, seguirono una via diversa, vuoi per la prematura scomparsa di Martin, vuoi per il successivo pensionamento del mio Maestro. Sicché, quando il loro progetto fu accantonato, i manoscritti rimasero nelle disponibilità della cattedra di lingua e letteratura albanese dell'Università di Palermo la quale, in tempi recenti, ha ritenuto di avviare alla realizzazione il nobile desiderio coltivato da Camaj e Guzzetta.

L'opera lessicografica è conservata in due valigie di cartone. Ognuna contiene dei fascicoli costituiti da fogli ritagliati (cm. 11 x 14,5) e compilati dall'Autore. Nei vari documenti manoscritti autografi La Piana a volte intitolò la sua opera Lessico comparato della lingua

albanese e a volte Dizionario della lingua albanese. Da un punto di vista contenutistico sarebbe forse più appropriato intitolarla più semplicemente Dizionario etimologico della lingua albanese. Nella prima valigia, oltre ad alcuni fascicoli, abbiamo rinvenuto copie delle pubblicazioni che La Piana riuscì a portare alla luce e che contengono riferimenti più o meno diretti a quelle sulle quali lavorava alacremente e che, purtroppo, non riuscì a pubblicare.

I fascicoli contenuti nelle due valigie sono complessivamente 46. Ce ne sarebbero stati 48 se fossero pervenuti anche altri 2 relativi alla lettera "P". A questi sono da aggiungere altri due fascicoli intitolati, rispettivamente, Suffissi e Bibliografia. Le misure fisiche sono grosso modo identici per tutti i fasc., ognuno dei quali è dotato di una doppia coperta rigida: nella prima sono riportati, in alto, la dicitura della lettera, quindi i numeri dei fogli e i lemmi di inizio e di fine fascicolo. Soltanto nei primi tre fascicoli è riportato anche il numero delle "schede", ovvero delle voci etimologiche discusse. Ciò rende difficile, allo stato attuale, di determinare il numero complessivo dei lemmi. Stando però a quanto afferma lo stesso autore nella Prefazione alla sua Grammatica storica della lingua albanese inedita, sarebbero 30.000 le parole da La Piana sottoposte ad analisi etimologica. Un numero indubbiamente rilevante che di per sé costituisce un autentico primato per i tempi in cui fu redatto il dizionario e che, considerato a distanza di oltre mezzo secolo, dà la misura del grande e costante impegno scientifico e intellettuale dispiegato da una delle più brillanti menti linguistiche che abbia avuto la storia della linguistica albanese. Di certo, se queste due opere inedite di La Piana fossero state pubblicate per tempo avrebbero recato grande giovamento alla conoscenza diacronica dell'albanese e, di rimando, avrebbero favorito uno sviluppo più rapido e sicuro di questo decisivo ramo dell'albanologia contemporanea.

MBI FJALORIN ETIMOLOGJIK TË PABOTUAR TË MARKO LA PIANËS

Njihet kontributi shkencor i studiuesit Marco La Piana në lëmin e gjuhësisë historike shqipe. Dihet edhe fakti se ai la të pabotuara dy vepra të vëllimshme, gramatikën historike dhe fjalorin etimologjik, dorëshkrimet e të cilave ruhen pranë arkivit të Seminarit Arbëresh të Horës së Arbëreshëve. Për këto dorëshkrime aty nga fundi i viteve '80 u interesuan profesorët Antonino Guzzetta dhe Martin Camaj, që i kërkuan Eparkut të asaj kohe t'i merrnin në dorëzim me qëllim që t'i përgatisnin për botim e të nderonin kështu kujtimin e Autorit. Mirëpo për shkak të vdekjes së parakohshme të Camajt dhe daljes në pension e prof. Guzzetta-s ky projekt nuk mundi të realizohej dhe dorëshkrimet mbetën në dispozicion të katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Universitetit të Palermos, e cila tashmë ka vendosur ta përmbushë dëshirën e profesorëve Camaj e Guzzetta.

Vepra leksikografike ruhet në dy valixhe kartoni. Secila syresh përmban fashikuj me skeda leksikografike në fletë të prera me format 11 x 14,5 cm. Në dokumente të ndryshme dorëshkrim që ruhen mes letrave të autorit ai e quan këtë vepër herë Lessico comparato della lingua albanese e herë Dizionario della lingua albanese. Gjykuar nga përmbajtja, ndoshta do të ishte më me vend ta quanim thjesht Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. Në valixhen e parë, përveç fashikujve me skedat leksikografike, kemi gjetur edhe disa kopje të botimeve që La Piana arriti të shtypte sa që gjallë, të cilat janë vetëm një pjesë e vogël e korpusit të studimeve në lëmin e historisë së gjuhës shqipe që autori na ka lënë në dorëshkrim.

Fashikujt që përmbajnë dy valixhet janë gjithsej 46. Mungojnë dy fashikuj që duhej të përmbanin germën "P". Këtyre u shtohen dy fashikuj të tjerë, të titulluar përkatësisht Suffissi dhe Bibliografia. Përmasat fizike janë pak a shumë të njëjta për të gjithë fashikujt, secili syresh mbledhur me një ballinë kartoni, ku autori ka shënuar në pjesën e sipërme germën përkatëse e më poshtë numrat e fletëve, si edhe lemën e parë e të fundit të fashikullit. Vetëm në tre fashikujt e parë sillet edhe numri i "skedave" ase i zërave etimologjike që trajtohen. Kjo e vështirëson përcaktimin e numrit të përgjithshëm të fjalëve të këtij fjalori. Mirëpo, me sa thotë vetë autori në Hyrjen e Gramatikës historike të gjuhës shqipe, kjo vepër përmban analizën etimologjike të rreth 30.000 fjalëve. Bëhet fjalë për një numër të madh që shënon një primat të padiskutueshëm për kohën kur u shkrua vepra dhe dëshmon angazhimin e vazhdueshëm shkencor e intelektual të njërit prej studiuesve më të shquar në historinë e albanologjisë. S'ka dyshim se, sikur këto vepra të ishin botuar me kohë, do t'i kishin sjellë një kontribut të paçmuar studimeve historike të shqipes e do të kishin ndihmuar zhvillimin më të shpejtë e më të sigurt të këtij lëmi të albanologjisë.

* * *

Dr. Gëzim Gurga
(Universität Palermo)

L'OPERA INEDITA DI MARCO LA PIANA: "GRAMMATICA STORICA DELLA LINGUA ALBANESE"

Marco La Piana (1883-1958), scopritore del codice manoscritto dell'opera di Luca Matranga *E mbsuame e krështerë*, (1592), del secondo libro conosciuto in albanese dopo il Meshari di Buzuku, è stato anche uno degli studiosi più prolifici nell'ambito della storia della lingua albanese. Oltre all'edizione critica della ricordata opera di Matranga, nel corso della sua vita ebbe modo di pubblicare soltanto alcuni suoi studi, in verità i più brevi, ben noti e apprezzati dagli albanologi, lasciando invece inediti altre ben più corpose e importanti.

Il corpus manoscritto con la "grammatica storica" dall'autore intitolata *Grammatica comparata della lingua albanese*, si conserva in due grosse carpette di cartone che, oltre al testo dell'opera in parola, contengono anche altri tre studi manoscritti, soprattutto articoli preparati per la stampa, ma che mai videro la luce.

La *Grammatica* si compone di due parti, la *fonetica* e la *morfologia*, ognuna delle quali è dotata di una numerazione indipendente dei capitoli. Il corpus contiene parti incomplete di alcune vvarianti manoscritte con una numerazione diversa dei fogli.

La "fonetica" ci è pervenuta in una variante definitiva che comprende i capitoli I - XXXVIII per 1133 pagine recante una numerazione a matita riportata nell'estremo lembo destro di ogni foglio.

La "morfologia" ci è pervenuta in tre varianti incomplete che comprendono i capitoli I - XLV e che contano complessivamente più di 1000 faqe recanti tre diverse numerazioni, due di colore blu, una a matita, anch'esse non complete, come anche un numero considerevole di fogli sparse e prive di numerazione con schede di lavoro e paragrafi relativi a parti diverse dell'opera.

Per fortuna l'autore ha provveduto a predisporre due fascicoli manoscritti contenenti gli indici (quadro riepilogativo) e due varianti finali dell'opera. Il primo indice, intitolato "Indice vecchio", è completo. A questo corrisponde una delle numerazioni parziali con colore blu dei manoscritti. Il secondo indice, intitolato "indice nuovo", si interrompe nel foglio 1390 dove termina il secondo capitolo della morfologia e coincide con la numerazione finale consecutiva segnata a matita.

Grazie a questi due indici, che ci offrono un dettagliato quadro riepilogativo sia degli argomenti che avrebbe dovuto comprendere l'opera che della sua struttura definitiva, oggi siamo in grado di ricostruire un testo più o meno completo con i frammenti delle diverse varianti pervenute, comprese quelle parti smembrate e sparse, del tutto prive di numerazione, rispettando così, per quanto possibile, l'ultima volontà dell'autore.

La prossima imminente pubblicazione di quest'opera monumentale, ne siamo pienamente convinti, non solo completerà, benché con oltre mezzo secolo di ritardo, il desiderio dell'autore che per la sua elaborazione le dedicò la sua vita, ma si colmerà una lacuna molto visibile degli studi linguistici offerti nel passato alla lingua albanese.

VEPRA E PABOTUAR E GJUHËTARIT ARBËRESH MARCO LA PIANA "GRAMMATIKË HISTORIKE E GJUHËS SHQIPE"

Marco La Piana (1883-1958), zbuluesi i kodikut me dorëshkrimet e veprës së Lekë Matrangës E mbsuame e krështerë, (1592), pra të librit të dytë që njohim në gjuhën shqipe pas Mesharit të Buzukut, është edhe një ndër studiuesit më aktivë dhe më prodhimtarë në lëmin e historisë së gjuhës shqipe. Përveç botimit të parë kritik të veprës së Matrangës, sa ishte gjallë ai mundi të botonte vetëm disa studime të shkurtra gjuhësore që tashmë njihen nga studiuesit.

Korpusi me dorëshkrimet e "gramatikës historike" që autori e quan "Grammatica comparata della lingua albanese" ruhet në dy dosje të trasha kartoni që, përveç veprës në fjalë, përmbajnë edhe tri studime të tjera në dorëshkrim, kryesisht artikuj të përgatitur për shtyp, por që nuk e panë kurrë dritën e botimit.

“Gramatika” përbëhet nga dy pjesë, “fonetika” dhe “morfologjia”, secila syresh me një numërtim të pavarur kapitujsh. Korpusi përmban pjesë të paplota të disa varianteve dorëshkrim me numërime të ndryshme faqesh.

“Fonetika”, na ka mbërritur në një variant të plotë dorëshkrim që përfshin kapitujt I - XXXVIII dhe përmban 1133 faqe të numëruara me laps në skajin e sipërm djathtas të çdo faqeje.

“Morfologjia” na ka mbërritur në së paku tri variante të paplota dorëshkrim që përfshijnë kapitujt I - XLV dhe gjithsej përmbajnë më se 1000 faqe me tri numërime të ndryshme, dy me bojë blu, një me laps, edhe këto të paplota, si edhe një numër të konsiderueshëm fletësh të palidhura e pa numërim me skeda pune e paragrafë që u përkasin pjesëve të ndryshme të veprës.

Për fat të mirë autori na ka lënë dy fashikuj dorëshkrim që përmbajnë indekset (pasqyrën e lëndës) e dy varianteve të fundit të veprës. Indeksi i parë, titulluar nga autori “Indice vecchio” është i plotë. Këtij i përgjigjet një nga numërimet e pjeshme me bojë blu të dorëshkrimeve. Indeksi i dytë, titulluar “indice nuovo”, ndërpritet në faqen 1390 ku përfundon kapitulli i dytë i morfologjisë dhe përkon me numërimin e fundit konsektiv me laps.

Falë këtyre dy indekseve që na japin një pasqyrë të detajuar të lëndës që duhej të përmbante vepra si edhe të strukturës së saj përfundimtare, sot jemi në gjendje të rindërtojmë një tekst pak a shumë të plotë me fragmentet e varianteve të ndryshme që na kanë mbërritur, përfshirë edhe ato pjesë të shkëputura e të shpërndara që nuk kanë asnjë lloj numërtimi, duke respektuar kështu, për sa është e mundur, vullnetin e fundit të autorit.

Botimi së shpejti i kësaj vepre monumentale jemi të bindur se jo vetëm që do të plotësojë, edhe pse gjysmë shekulli me vonesë, dëshirën e autorit që i kushtoi jetën hartimit të saj, por do të mbushë edhe një zbrazëti të ndjeshme në studimet gjuhësore në fushë të shqipes.

6. SESSION: 11.30 - 13.:00 Uhr

Prof. Dr. Tomor Osmani / Dr. Mimoza Priku
(Universitët Shkodër)

NJËSIMI I ALFABETIT DHE I GJUHËS LETRARE SË PËRBASHKËT - DY PROBLEME GJUHËSORE PARËSORE TË VITEVE TË PARA TË SHEKULLIT XX

Në këtë shkrim autorët merren me dy probleme themelore të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek XX: njësimin e alfabetit të shqipes dhe çështjen e zgjidhjes së gjuhës së përbashkët shqipe. Në këto kushte rol të veçantë luante edhe faktori kulturor-arsimor, prandaj shqiptarët duhej të ndërjegjësoheshin që veprimtarinë politike ta shoqëronin me një lëvizje kulturore.

Në hapësirën ballkanike Shqipëria ishte i vetmi vend që nuk kishte një sistem shkrimi unik, kur dihet se shqiptarët trashëguan dhe e ruanin me kohë individualitetin kulturor dhe gjuhësor.

Çfarë ofronte gjendja ekzistuese? Në fushën e shkrimit përpjekjet ishin më shumë vetjake sesa kolektive, për të zgjidhur këtë problem jo thjesht me karakter kulturor, por edhe politik, pasi shumë autorë shkruanin duke përdorur secili sipas dëshirës së tyre një sistem shkrimor të huazuar nga të tjerët ose të krijuar nga ata vetë. Ngjarja që i dha fund kësaj odiseje që prej shekullit XV, ishte Kongresi i Manastirit, i cili u mbledh më 14 nëntor 1908, duke miratuar alfabetin që kemi sot. Ndërsa Kongresi i Elbasanit, një kongres mbarëkombëtar që zhvilloi punimet më 2-9 shtator 1909, erdhi si një veprim jo vetëm i natyrshëm, por edhe i domosdoshëm, pasi mori vendime të rëndësishme, si njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare dhe për përhapjen e shkollave në gjuhën amtare dhe të së parës shkollë normale që do të përgatiste mësuesit e ardhshëm. Në këtë periudhë vihet re një aktivizim i shumë personaliteteve për hartimin e abetareve dhe teksteve shkollore, si edhe për hartimin e gramatikave dhe të fjalorëve. Pas Alfabetares së Shoqërisë së Stambollit (1879), duhet të përmendim abetaret e shoqërisë “Bashkimi”, abetarja e Gaspër Benusit, Luigj Gurakuqit, Parashqevi Qiriazi etj. etj. Më 1886 Sami Frashëri botoi “Shkronjëtoe e gjuhës shqipe” që

ishite e para gramatikë për shqipen në gjuhën shqipe. Kështu për një periudhë 20-vjeçare 1900-1920 u botuan rreth 20 gramatika.

Kështu, në vitet e para të shekullit XX shkolla shqipe në veçanti dhe kultura shqiptare në përgjithësi u pajis me botimet më të domosdoshme, si: abetare, tekste mësimore, gramatika dhe fjalorë, pasi kishte zgjidhur një ndër problemet më komplekse dhe më të vështira, njësimin e alfabetit të shqipes.

Problemi i dytë ishte zgjidhja e një gjuhe të përbashkët për të dy dialektet, problem i ngritur nga shumë patriotë të Rilindjes sonë Kombëtare. Një elitë intelektuale themeloi në shtator të vitit 1916 Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër. Për mënyrën e zgjidhjes, e veçanta e Komisionit që e dalloi këtë institucion ishte diskutimi i problemeve gjuhësore me kompetencë shkencore, tolerancë, larg qëndrimeve të ngushta lokaliste. Këtë e vërteton më së miri vendimi që u mor nga kjo Komisi që si bazë për gjuhën e përbashkët do të ishte e folmja e Elbasanit. KLSH i dha një shtytje të veçantë procesit të konvergjençës gjuhësore dhe ndikoi në zhvillimin e shqipes moderne për shumë kohë.

